



safejournalists.net

SHQIPËRI Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2021



SHQIPËRI
Treguesit e Nivelit
të Lirisë së Mediave
dhe Sigurisë së
Gazetarëve në
Shqipëri 2021

Autor
Blerjana Bino

Titull në origjinal

Shqipëri – Treguesit e Nivelit të Lirisë së Mediave dhe Sigurisë së Gazetarëve në Shqipëri 2021)

Botues

Shoqata e Gazetarëve të Pavarur të Serbisë
Tiranë, 2022

Autor

Blerjana Bino

Proofreading

Durim Tabaku

Redaktorë

Kristina Voko

Blerina Fani

Përkthimi

Durim Tabaku

Fotoja e kopertinës

Andrija Vukelic


Realizimi grafik

comma.rs

Tirazhi

50

Ky botim u realizua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Fondit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Marshall Gjerman i Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në të nuk pasqyrohen domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze, Fondit Ballkanik për Demokraci, të Fondit Marshall Gjerman të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.



A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Tabela e përmbajtjes

Hyrje	7	B3 Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik	24
A Mbrojtja ligjore	10	B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse	24
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimimi i tyre në praktikë	10	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	25
A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes të gazetarët	14	B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare	26
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	15	C Siguria e gazetarëve	27
A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika	17	C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë	27
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	18	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve	30
A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni	19	C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve	31
B Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve	22	Përfundimet dhe rekomandimet	33
B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve	22		
B2 Pavarësia editoriale në mediat private	23		

Përmbledhja dhe qëllimi i projektit

Me mbështetjen e Komisionit Evropian¹, shoqatat e gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar një platformë të përbashkët [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net) për të monitoruar ndryshimet në legjislationin dhe praktikën e vendeve të tyre dhe për t'u angazhuar në aktivitete të ndryshme advokimi që synojnë përmirësimin e mjedisit politik, legjislativ dhe institucional në të cilën punojnë gazetarët dhe mediat. Duke filluar nga viti 2020, anëtarët e platformës kanë monitoruar situatën në shtatë shtete (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Maqedoninë e Veriut, Mal i Zi, Kosovë² dhe Serbi). Çdo vit bëhet një vlerësim i situatës në bazë të metodave të standardizuara për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave³, ndërkohë hulumtimi përqendrohet te ndryshimet në mjedisin mediatik tradicional dhe atë online në Ballkanin Perëndimor.

-
- ¹ Në dhjetor 2019, Komisioni Evropian miratoi projektin tre-vjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), i cili synon fuqizimin e shoqatave kombëtare të gazetarëve nga vendet e Ballkanit Perëndimor për t'u bërë aktorë të pavarur efektivë dhe të përgjegjshëm për mbrojtjen dhe zbatimin e standardeve të BE-së në fushën e lirive të medive, me qëllim afatgjatë të përmirësimit të të drejtave të qytetarëve për të bërë zgjedhje të bazuar në informacione. Ky veprim përfaqëson kalimin në një tjetër nivel të projektit të mëparshëm (Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Mbrojtjen e Lirisë së Medias dhe Sigurisë e Gazetarëve), bazuar në njohuritë dhe përvojën e akumuluar në periudhën 2016-2018. Ky projekt financohet në kuadër të Programit për Shoqëritë Civile dhe Media 2020-2022 Mbështetje për Rrjetet Tematike Rajonale të Organizatave të Shoqërisë Civile.
 - ² Ky emër është pa paragjykim për statusin dhe në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe me opinionin e Tribunalit për Shpalljen dhe Pavarësinë e Kosovës.
 - ³ Edicioni i parë i metodologjisë së kërkimit për këtë projekt kërkimor advokimi u hartua në vitin 2016 dhe më pas u përshtat me kalimin e viteve për të pasqyruar situatën në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ky hulumtim u hartua dhe koordinua nga Snezana Trpevska dhe Igor Micevski, bashkëpunëtorë shkencorë të Institutit Kërkimor për Zhvillimin Social RESIS nga Maqedonia e Veriut. (www.resis.mk).

Dy fjalë për metodologjinë

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tre grupe treguesish të hartuar në bazë të një analizë të plotë të udhëzimeve të ndryshme të hartuara nga organizatat përkatëse ndërkombëtare. Gjatë viteve të kaluara, treguesit e mëparshëm u testuan dhe u përpunuan me qëllim trajtimin sa më koherent të kontekstit të veçantë social-politik të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe për të pasqyruar nevojat specifike dhe interesat e gazetarëve në të shtatë vendet e rajonit.

U zbatuan një sërë metodash të ndryshme kërkimore për të mbledhur dhe analizuar të dhënat me qëllim që t'i japim përgjigje pyetjeve që lidhen me secilin tregues specifik:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve kërkimore, dokumenteve politike, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analizës cilësore e dokumenteve ligjore;
- Marrja dhe analizimi i informacionit të botuar në faqet zyrtare të institucioneve publike dhe organizatave dhe enteve të tjera;
- Marrja dhe analizimi i deklaratave për shtyp, njoftimeve dhe informacioneve të tjera të prodhuara nga organizatat profesioniste;
- Të dhënat dytësore të mbledhura nga shoqatat e gazetarëve;
- Intervista të thelluara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës, etj.;
- Diskutime në fokus grupe me gazetarë; dhe
- Sondazh me gazetarët (në disa vende).

Në Shqipëri, hulumtimi i advokimit u realizua nga studiues kombëtarë që mbledhën të dhënat dhe hartuan raportin narrativ, i cili më pas u rishikua nga ekspertë vendas për median dhe nga drejtuesi i hulumtimit. Në këtë vend të Ballkanit Perëndimor, për redaktimin e raportit Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt angazhoi Blerjana Binon si studiuese kombëtare dhe ekspertën e medias Kristina Voko për rishikimin.

Table 1: Indicators of the level of media freedoms and safety of journalists in Albania

A Mbrojtja ligjore	B Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve	C Siguria e gazetarëve
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe gazetarëve dhe zbatimin e tyre në praktikë	B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve	C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë
A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes të gazetarët	B2 Pavarësia editoriale në mediat private	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	B3 Pavarësia editoriale e transmetuesve të shërbimit publik	C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve
A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika	B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse	
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni	B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare	

List of Abbreviations

AMA – Autoriteti i Mediave Audiovizive
AKCESK – Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike
ISP – Ofruesit e shërbimeve të internetit
AKEP – Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
ATSH – Agjencia Telegrafike Shqiptare
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KE – Komisioni Evropian
BE – Bashkimi Evropian
OSHEE – Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
IREX – Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave
RTSH – Radio Televizionit Shqiptar
ATSH – agjencisë publike e lajmeve
TSHP – Transmetuesi i Shërbimit Publik
SPAK – Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
KQZ – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
AMI – Agjenci e re për Mediat dhe Informim
KLP – Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KLGJ – Këshilli i Lartë Gjyqësor
IPI – Instituti Ndërkombëtar i Shtypit
JUFREX – Instrumenti Horizontal i Lirisë së Shprehjes dhe Liria e Medias në Shqipëri

Pavarësisht progresit të konsiderueshëm drejt demokratizimit të vendit tridhjetë vjet pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria ka bërë hapa prapa në demokraci në këto vitet e fundit, siç dëshmohet nga raportet ndërkombëtare për gjendjen e demokracisë në vend.⁴ Shqipëria është republikë parlamentare me parlament me një dhomë dhe ka një kushtetutë të miratuar në 1998 me ndryshime në 2008 dhe 2020. Ka sistem zgjedhor proporcional rajonal. Ajo është anëtare e NATO-s që nga viti 2009 dhe e konsideron aleancën e saj Euro-Atlantike të një interesi strategjik kombëtar me rol përgjithësisht konstruktiv në Ballkanin Perëndimor.⁵ Pakicat kombëtare në Shqipëri janë ato greke, maqedonase, vllah/arumune, rome, egjiptiane, malazeze, bullgare, boshnjake dhe serbe.⁶

Rruga drejt integritimit evropian ka qenë shpesh forca kryesore lëvizëse e reformave demokratizuese në Shqipëri dhe më gjerë në rajon. Shqipëria është vend kandidat i Bashkimit Evropian (BE) që nga viti 2014 dhe hapi negociatat e anëtarësimit me BE-

4 *Indeksi botëror i gjendjes së demokracisë (The Global State of Democracy Index) 2021.* <https://bit.ly/3MPVvr7>

5 *Komisioni Evropian. Raporti për Shqipërinë 2020, f. 8. Akseluar më 20.1.2021:* https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/albania_report_2020.pdf

6 *Ligji Nr. 96/2017, "Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë". Akseluar më 20.1.2021:* <https://bit.ly/3OIV8TO>

në në mars 2020⁷, në pritje të përbushjes së një sërë kushtesh. Zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021 u konsideruan një moment historik i rëndësishëm në rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE, në drejtim të konferencës së parë ndërqeveritare. Gjithsesi, muaji qershor 2021 ishte zhgënjyes ku BE dështoi në arritjen e një marrëveshjeje për fillimin e bisedimeve të anëtarësimit në BE për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut pas mbajtjes së konferencës së parë ndërqeveritare.

Aktualisht, mungesa e progresit ka çuar në perceptimin se procesi ka ngecur duke sjellë si rezultat zhgënjim tek elitat politike në vend dhe madje edhe tek vetë qytetarët. Studiuesit argumentojnë se ndjesia e largimit nga BE-ja është vetëm një fazë e ndërmjetme drejt fazës tjetër të 'Paparashikueshmërisë së Re', e cila po shfaqet në të gjithë rajonin.⁸ Pavarësisht përpjekjeve për vite me radhë për të nxitur demokratizimin në Shqipëri dhe rajon, politikat e BE-së nuk kanë sjellë ndryshimin e pritshëm duke qenë se procesi i zgjerimit ka humbur efikasitetin dhe vulltin politik.⁹ Paparashikueshmëria e re nënkupton se shteti ligjor dhe demokracia nuk do të jenë më prioritet kryesor duke pasur parasysh rënien e fuqisë transformuese të integritimit evropian. Ky kontekst politik ka implikime për ekosistemin e përgjithshëm të lirisë së medias duke pasur parasysh tendencat në rritje të stabilizimokracisë: qeveritë, që pretendojnë se ofrojnë stabilitet, sillen sikur mbështesin integritimin në BE, por mbështeten në strukturat informale, klienteliste, në kontrollin e medias dhe prodhimin e vazhdueshëm të krizave për të minuar demokracinë dhe shtetin e së drejtës.¹⁰

Në Shqipëri, në parim pushteti qendror dhe ai vendor janë demokratikë, por në praktikë ato dominohen nga politika klienteliste partiake¹¹ dhe niveli i lartë i korrupsionit. Sipas Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit

për 2021 të Transparency International, Shqipëria renditet e 110 nga 180 vende, duke shënuar një rënie prej 27 vendesh që nga vitet 2016, dhe 6 vende që nga viti 2020.¹² Edhe pse Shqipëria është disi e përgatitur për të luftuar korrupsionin, në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit dhe mbetet një problem shqetësues e serioz sipas raportit të KE.¹³ Në vitet 2020 dhe 2021, pandemia COVID-19 u përdor si justifikim për të ulur kontrollin dhe llogaridhënien e institucioneve publike, veçanërisht në prokurimin publik dhe në shpenzimet e ndihmës së huaj.¹⁴ Edhe në Raportin 'Kombet në Tranzit' evidentohet se kufizimet e COVID-19 u keqpërdorën për të shmanjur kontrollin dhe transparencën në miratimin e ligjeve të reja.¹⁵ Në përgjithësi, kriza e COVID-19, e cila ka tërhequr vëmendjen e qeverisë dhe ka varfëruar burimet publike, ka ndikuar negativisht në ecurinë e mëtejshme të reformave kryesore.¹⁶

Në vitin 2021, ashtu si edhe në vitet e mëparshme, peizazhi politik u karakterizua nga një polarizim i tejkashtë jo vetëm mes pozitës dhe opozitës, por edhe brenda vetë partisë kryesore opozitare, të cilat shpesh kanë prioritet ndaj zhvillimit të politikave publike dhe reformave të nevojshme. Aktualisht, Partia Socialiste e Shqipërisë është në pushtet në mandatin e saj të tretë, pas fitores në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021. Edhe pse zgjedhjet ishin konkurruese, votuesit kishin mundësi zgjedhjeje për kandidatë, të cilët mund të bënin fushatë lirish, sipas një kuadri ligjor që respekton liritë themelore, ende evidentohen disa shqetësime, si p.sh., shfrytëzimi nga partia në pushtet i avantazhevetë mëdha të pushtetit; mbulimi me pozitivitet i institucioneve shtetërore në media dhe akuza për blerje votash, mashtrime dhe manipulime.¹⁷ Për sa i përket qeverisjes vendore, që nga viti 2021, Partia Socialiste kontrollon 59 nga 61 bashkitë¹⁸ në vend, pas bojkotit nga opozita të zgjedhjeve vendore të 2019. Zgjedhjet e pjeshme vendore që u mbajtën në mars 2022 nuk sollën ndryshime në këtë konfigurim politik në nivel vendor.

7 Këto korniza përcaktojnë udhëzimet dhe parimet që rregullojnë negociatat e anëtarësimit për secilin vend kandidat. https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/countries/detailed-country-information/albania_en. Konferencat e para ndërqeveritare duhet të mbledhen sa më shpejt të jetë e mundur pas miratimit të kornizave negociuese nga Këshilli. Para konferencës së saj të parë ndërqeveritare, Shqipëria është kërkuar të bëjë përparim të mëtejshëm me reformat zgjedhore dhe gjyqësore dhe me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Edhe trajtimi i fenomenit të azilkerkuesve pa shkak dhe ndryshimi i ligjit për media mbeten përparësi të rëndësishme. Komisioni do të raportojë për këto çështje kur të paraqesë kornizën negociuese për Shqipërinë. Për më shumë hollësi vizitoni https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/pt/ip_20_519

8 Vurmo, G. (2021). "The EU and the Western Balkans – Serving the Purpose of Enlargement", BIEPAG. <https://bit.ly/3QIOAFg>

9 Zweers, W. & Cretti, G. (2022). "The EU as a Promoter of Stability in [the] Western Balkans?". <https://www.clingendael.org/publication/eu-promoter-stability-in-western-balkans>

10 Biber, F. (2018) "Shkëlqimi (dhe Rënia) e Stabilokracive në Ballkan". <https://bit.ly/3aRikGO>

11 Hoxhaj, A. (2022). Nations in Transit Albania 2022. <https://bit.ly/3HoRvsv>

12 Transparency International, Indeks i Perceptimit të Korrupsionit 2021, Shqipëria, (2022). <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

13 Komisioni Evropian, 2021. Progresi Raporti për Shqipërinë 2021, p.6. Aksesusuar më 15.3.2022. https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/albania-report-2021_en

14 Transparency International, Indeks i Perceptimit të Korrupsionit 2021, Shqipëria, (2022). Aksesusuar më 15.3.2022. <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

15 Hoxhaj, A. (2022). Nations in Transit Albania 2022. Aksesusuar më 3.5.2022. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2022>

16 BTI 2022. Raporti për Shqipërinë 2022. Aksesusuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3wPwAaQ>

17 Misioni i Kufizuar i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar, (2021). Aksesusuar më 15.3.2022. <https://www.osce.org/files/f/ documents/4/c/495052.pdf>

18 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Të dhënat për bashkitë. Bashkia e Shkodrës drejtohet nga Partia Demokratike dhe Bashkia e Finiqit nga Partia MEGA e minoritetit grek. Aksesusuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3xwUjvJ>

Në vitin 2021, mungesa në përgjithësi e kulturës së hapjes në institucionet publike, e dukshme në praktikën e tyre të papërgjegjshme, angazhimi selektiv i aktorëve kryesorë dhe tendenca për të mos dhënë informacione vihet re dhe konfirmohet në raporte të ndryshme. Në dokumente, Shqipëria duket se ka një mjedis të larmishëm të shoqërisë civile¹⁹, por me kufizime të konsiderueshme në praktikë për sa i përket pjesëmarrjes së vërtetë në procesin e konsultimit. Në raportin KE-së theksohet se është bërë përparim i kufizuar në zbatimin e udhërrëfyesit për krijimin e një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile dhe se konsultimi publik me shoqërinë civile²⁰ dhe grupet e interesit mbetet thjesht formal dhe i kufizuar në ndikimin e tij edhe në vitin 2021.²¹

Sipas Bankës Botërore, Shqipëria është ekonomi në tranzicion që ka zbatuar reforma të rëndësishme strukturore drejt rritjes së barabartë, prodhimit, konkurrueshmërisë, krijimit të vendeve të punës dhe përmirësimit të shërbimeve publike.²² Në vitet e fundit, qeveria është përqendruar në rimëkëmbjen nga pandemia dhe tërmeti shkatërrues i nëntorit 2019, një proces që ka hasur në sfida të mëdha që ndikojnë në përpjekjet e saj për të arritur një rikuperim të qëndrueshëm. Banka Botërore vlerëson se në vitin 2021, investimet private, konsumi dhe shpenzimet publike nxitën rritjen, ndërsa borxhi publik mbeti ende shumë i lartë.²³ Rritja e inflacionit dhe lufta në Ukrainë kërcënojnë perspektivat ekonomike dhe ndikojnë në rritjen e varfërisë për vitin 2022 në Shqipëri. Po ashtu, OECD thekson se edhe pse autoritetet vepruan shpejt dhe morën masa për të zbutur efektet negative të kufizimeve të COVID-19 në ekonomi, ndikimi ekonomik dhe social i pandemisë varet kryesisht nga dobësitë e mëparshme socio-ekonomike dhe qëndrueshmëria e politikave në Shqipëri.²⁴

Mediat në Shqipëri kanë bërë transformime të mëdha duke iu përgjigjur zhvillimeve social-kulturore, politike dhe ekonomike të vendit dhe përparimeve në teknologji, tendencave globale të medias dhe, së fundmi, edhe krizës COVID-19.²⁵ Tipari kryesor i sistemit mediatic në Shqipëri është dominimi nga mediat klienteliste, sistem që karakterizohet nga ndërvarësia dhe lidhjet e fshehta mes mediave, politikës dhe biznesit. Ekziston një sistem transmetimi i dyfishtë, ku bëjnë pjesë Radio

Televizioni Shqiptar (RTSH) i cili është transmetuesi i shërbimit publik dhe media e lulëzuar private me 3 kanale televizive kombëtare, përkatësisht Top Channel, TV Klan dhe Media Vizion. Në vend janë licencuar edhe dy transmetues kombëtarë për platformat digjitale. Janë licencuar edhe 42 kanale të tjera televizive, tre radio kombëtare, 56 radio lokale²⁶, dhe me më shumë se 650 media online.²⁷ Pavarësisht rritjes eksponenciale të numrit të mediave në dekadën e fundit, veçanërisht mediave online, cilësia e përmbajtjes mediatike mbetet një sfida dhe në vitin 2021 cilësia e përmbajtjes mediatike u përkeqësua edhe më shumë.²⁸ Respektimi i standardeve etike dhe i rregullave të së drejtës së autorit si dhe profesionalizmi ende nuk janë konsoliduar për një sërë arsesh. Ndonëse Kushtetuta e Shqipërisë parashikon lirinë e shprehjes dhe qeveria zakonisht i respekton këto të drejta, në vitin 2021 pati raportime se qeveria, bizneset dhe grupet kriminale kërkonin të diktonin ndikimin e tyre të padrejtë në media.²⁹ Shqipëria ka një mjedis mediatic të mbipopulluar për sa i përket numrit të mediave, por një treg të kufizuar reklamash dhe përqendrim të pronësisë së mediave tek disa pronarë/familje që i përdorin ato si mjet për ndikim politik dhe ekonomik.

19 Hoxhaj, A. (2022). *Nations in Transit Albania 2022*. Aksuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3z7PYVX>
20 Komisioni Evropian, 2021. Progresi Raporti për Shqipërinë 2021, p.3. Aksuar më 15.3.2022. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en
21 Po aty, f.12.
22 Përmbledhja për Shqipërinë, 2022, Banka Botërore. Aksuar më 3.5.2022. <https://www.worldbank.org/en/country/albania/overview#1>
23 Ibid
24 OECD, (2022). "Impact of COVID-19 in Albania". Aksuar më 3.5.2022 <https://bit.ly/3QqJap>
25 Bino, B. (2021). "Media Freedom in Albania: Such a Frail Thing", p. 9-15. Aksuar më 3.5.2022 <https://bit.ly/3tD14zQ>

26 Autoriteti i Mediave Audiovizive, për më shumë vizitoni. Aksuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3OkBXIQ>
27 Kjo është me përparësi se nuk ka të dhëna të besueshme.
28 Hoxhaj, A. (2022). *Nations in Transit Albania 2022*, për më shumë vizitoni. Aksuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3xXVXM2>
29 Departamenti i Shteti i ShBA-ve, Raporti për Shqipërinë 2021. Aksuar më 3.5.2022. <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>

A

A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe të gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë

A garantohet e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit? A përfshin kjo e drejtë edhe aksesin në internet? A zbatohen në praktikë garancitë ligjore?

Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe lirinë e informimit³⁰. Ajo parashikon që e drejta e lirisë së shprehjes, të medias dhe informimit mund të kufizohet me ligj “për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve”.³¹ Legjislacioni në fuqi për lirinë e shprehjes nuk përfshin drejtpërdrejt aksesin në internet. Megjithatë, në Shqipëri, aksesin në internet garantohet përmes Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Kuadri ligjor për të drejtën e lirisë së shprehjes dhe informimit nuk zbatohet plotësisht në praktikë me shenja të përkeqësimit të lirisë së shprehjes, të informimit dhe të shtypit, të cilat vazhduan edhe në vitin

30 Neni 22 i Kushtetutës shprehet: “Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shtypit, e radios dhe e televizionit është e garantuar. Censura paraprake e mjeteve të komunikimit ndalohet. Ligji mund të kërkojë dhënien e autorizimit për funksionimin e stacioneve të radios ose të televizionit.” Neni 23 i Kushtetutës garanton në mënyrë të veçantë lirinë e informimit: “E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.”

31 Kushtetuta përcakton se këto kufizime duhet të jenë “në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë” dhe se “në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

2021. Në raportine KE-së theksohet se Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për sa i përket lirisë së shprehjes dhe se nuk vihet re asnjë përparim në vitin 2021.³² Përveç kësaj, Raporti i Kombeve në Tranzit thekson se viti 2021 ishte mjaft i vështirë për gazetarët për shkak të kërcënimeve, ngacmimeve dhe kushteve të tmerrshme të punës.³³ Së fundi, renditja e Shqipërisë ra me 20 vende në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit të Reporterëve pa Kufij, duke u renditur në vendin e 103 nga 180 në 2022.³⁴

A është hartuar legjislacioni për mediat nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në konsultim me shoqatat përkatëse profesionale?

Në 2021, Shqipëria nuk u angazhua në hartimin e legjislacionit të ri për median edhe pse Qeveria u zotua në tetor 2021 se do të rishqyrtonte ndryshimet në ligjin për median të miratuar në vitin 2019³⁵, të cilat u kritikuan ashpër nga organizatat mediatike vendase dhe ndërkombëtare.³⁶ Raporti i KE-së thekson se rishikimi i ligjit për mediat duhet të jetë në përputhje me Opininionin

e Komisionit të Venecias³⁷ dhe se duhet t'u paraqitet për konsultimin e duhur organizatave të mediave.³⁸

A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për të vendosur kërkesa të tjera për krijimin e mediave të shkruara dhe online? A shkojnë këto kërkesa përtej një regjistrimi të thjeshtë biznesi dhe te organet tatimore?

Në vitin 2021, nuk pati asnjë përpjekje rregullatore nga autoritetet shtetërore për të imponuar licencime ose kërkesa rigorozë për krijimin e mediave të shkruara dhe ato online. Ndonëse kryeministri ende deklaroi se synon t'i rikthehet përpjekjeve për rregullimin e mediave online,³⁹ amendamentet ende nuk janë propozuar. Aktualisht, nuk ka asnjë ligj që detyron licencimin e mediave të shkruara dhe atyre online përveç regjistrimit të biznesit dhe regjistrimit tek organet tatimore. Portalet online regjistrojnë domenin e tyre tek Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili u kërkon atyre të japin informacione bazë për pronësinë dhe informacione kontakti. Nëse portalet e reja kryejnë veprimtari ekonomike, të tilla si reklama dhe abonime, ato duhet të regjistrohen tek organet tatimore. Të dhënat për pronësinë e mediave mund të merren nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Nëse botuesi është ent jofitimprurës, ai duhet të regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Aktualisht, nuk ka asnjë përkufizim ligjor për mediat online.

A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për të kufizuar të drejtën e aksesit në Internet ose për të kërkuar bllokimin ose filtrimin e materialeve në internet?

Në vitin 2021, qeveria nuk e kufizoi apo nuk e ndërpreu aksesin në internet, përfshirë këtu autorizimin për mbyllje të pjesshme apo të plotë të aksesit në internet, apo nuk censuroi përmbajtjen online.⁴⁰ Ka pasur

32 Komisioni Evropian. (2022). Raporti për Shqipërinë 2021, p. 29. https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/albania-report-2021_en

33 Hoxhaj, A. (2022). Nations in Transit Albania 2022, për më shumë vizitoni. Aksesusar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3zGtDPi>

34 Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit i Reporterëve pa Kufij, 2022. Aksesusar më 5.5.2022. <https://rsf.org/en/country/albania>

35 Përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave, "Gjatë vizitës së Përfaqësuesit të OSBE-së për Lirinë e Mediave, autoritetet shqiptare ritheksuan se do t'i rishikonin ligjet për mediat në përputhje me standardet ndërkombëtare.", OSBE. Aksesusar më 15.10.2021. <https://www.osce.org/representative-on-freedom-of-media/500902>

36 Në dhjetor 2019, Qeveria shqiptare miratoi dy projektligje për rregullimin e medias, që ndërmerre një seri ndryshimesh në Ligjin Nr. 97/2013, "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë" dhe Ligjin Nr. 99/18, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë". Ndryshimet në Ligjin e Mediave Audiovizive u referuan si "ligji për mediat online" dhe u kundërshtuan gjerësisht nga shoqëria civile, organizatat e medias si dhe rrjetet dhe shoqatat rajonale e ndërkombëtare të mediave, sepse ndryshimet parashikonin kompetenca të mëdha Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) për të rregulluar përmbajtjen e medias, duke pasur parasysh se pavarësia dhe profesionalizmi i këtyre autoritetit nuk mund të siguroheshin, gjë që e kthente këtë autoritet në një instrument censure. Ligji u kthye mbrapsht nga Presidenti i Shqipërisë dhe u refuzua edhe nga Komisioni i Venecias që kritikuan në përgjithësi se ligji mund të kufizonte lirinë e shprehjes dhe lirinë e mediave online. Që nga ajo kohë, këto dy ligje ende nuk janë ndryshuar për të përmbushur standardet e kërkuara dhe renditen si "në proces" në regjistrin e Kuvendit, ndërkohë që qeveria pretendon se është tërhequr nga kjo nismë.

37 Këshilli i Evropës, Komisioni i Venecias, 980/2020 – Shqipëri – Opinion për Projekt Amendamentet për Ligjin Nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive". Aksesusar më 24.4.2021. <https://rm.coe.int/vc-opinion-albania-0620/16809ec9c9>

38 Komisioni Evropian, 2021. Progres Raporti për Shqipërinë 2021, p.30. Aksesusar më 3.05.2022. https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/albania-report-2021_en

39 Taylor, A. (2021) "Kryeministri i Shqipërisë bën thirrje për rregullimin e mediave online", Euroactiv. Aksesusar më 15.12.2021. <https://bit.ly/3xWaXd5>

40 Me krijimin e bazës së të dhënave online nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) në vitin 2020, ofruesit e shërbimeve të internetit (ISP) tani do të informohen automatikisht për të gjitha vendimet përkatëse për heqjen e përmbajtjeve të paligjshme që jepen nga autoritetet kompetente. Zbatimi i këtyre vendimeve do të monitorohet nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

raporte të besueshme se qeveria ka monitoruar komunikimet private online pa autorizimin e duhur ligjor.⁴¹Në Shqipëri, arsyet kryesore për kufizimet e mundshme të lirisë së shprehjes online të rregulluara me ligj përfshijnë shpifjen, gjuhën e urrejtjes, materialet që mbrohen nga e drejta e autorit si dhe mbrojtja e të dhënave. Teksa në vitin 2020 ka pasur disa raste të kufizimeve arbitrare të materialeve të mediave online për motive të përgjithshme si përhapja e panikut në publik në rastet e pandemisë COVID-19, në 2021 nuk u raportua asnjë rast i tillë.

A po i kryen autoriteti rregullator funksionet e tij në një mënyrë të pavarur dhe jo-diskriminuese? A administrohen rregulloret për licencimet dhe rregulloret e tjera të transmetimit në një mënyrë të drejtë dhe të paanshme?

Shqetësimet për Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) – autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive –në lidhje me pavarësinë dhe praktikën e punës së saj u rritën pas zgjedhjes së një personi me lidhje politike me partitë në pushtet si kryetar i AMA-s në korrik 2021, pavarësisht kritikave të vazhdueshme nga organizatat e pavarura të mediave.⁴²Nga organizata të ndryshme të pavarura u ngritën shqetësime serioze në lidhje me pavarësinë e kryetares së zgjedhur në korrik, të znj. Armela Krasniqi,⁴³ nisur nga lidhjet e saj të ngushta me kryeministrin Rama dhe Partinë Socialiste në pushtet. Më parë ajo kishte qenë zëdhënëse e Partisë Socialiste para se të emërohej në krye të Agjencisë Telegrafike Shqiptare që është në varësi të qeverisë.⁴⁴ Për më tepër, për vetë procesin zgjedhor u ngritën shqetësime edhe nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) si dhe nga BE, të cilat i kërkuan Kuvendit të Shqipërisë të shtynte votimin e korrikut deri në shtator për të lejuar futjen në parlamentin e ri dhe kthimin e partive opozitare që kishin bojkotuar parlamentin që nga shkurti i vitit 2019.⁴⁵ Kërkesa e tyre u shpërfill nga parlamenti.

Në vitin 2021,AMA funksiononte me burime të kufizuara njerëzore,duke qenë se të gjitha vendet në bordin drejtues, me përjashtim të kryetarit, ishin të lira gjatë periudhës 2019-2021. KE i kërkoi Parlamentit të ri të plotësonte

këto vende vakante dhe ta bënte AMA plotësisht funksionale për të siguruar kështu pavarësinë dhe legjitimitetin e këtij autoriteti rregullator.⁴⁶ Anëtarët e bordit drejtues të AMA-s u zgjedhën nga parlamenti i ri në shkurt 2022 sipas formulës së përfaqësimit në ligjin për median që i jep të drejtën opozitës dhe partisë në pushtet të refuzojnë kandidatët e propozuar nga organizatat e shoqërisë civile në Komisioni Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

A abuzohet me dispozitat ligjore për reklamën shtetërore në media për të ndikuar politikisht te politika e tyre editoriale? A është transparente, e drejtë dhe jo-diskriminuese ndarja e fondeve shtetërore? A i publikojnë rregullisht institucionet shtetërore të dhënat për shumën e akorduara për media të ndryshme?

Legjislati i mediave në Shqipëri trajton reklamën vetëm në drejtim të transmetimit audioviziv, ndërkohë që reklamimi në median e shkruar dhe atë online nuk rregullohet në ndonjë mënyrë specifike, por vetëm në kuadër të detyrimeve tatimore që duhet të paguhen sipas ligjeve për tatimet dhe biznesin. Edhe pse AMA monitoron volumin e reklamave në mediat audiovizive, raportet e saj nuk janë në gjendje të përcaktojnë pozicionin e secilës media për sa i përket tregut të reklamave.⁴⁷Burimi kryesor i financimit nga shteti për mediat private është financimi që jepet për transmetimin e reklamave ose njoftimeve shtetërore, ose financimi për ngjarje publike apo fushata publicitare. Megjithatë, ka shumë pak transparencë në lidhje me kriteret e ndarjes së fondeve shtetërore, për të dhënat specifike për shumën e alokuara dhe për konflikte të mundshme interesi. Zakonisht, institucionet shtetërore mund të përdorin ndërmarrje të shërbimeve komunale (si ujësjellës-kanalizime, OSHEE, etj.) ose agjenci reklamash për të shpërndarë fondet pa publikuar të dhëna të qarta në lidhje me kriteret dhe shumën e dhëna për mediat.Përqendrimi në pak duar i pronësisë së mediave është tejet shqetësues në Shqipëri, ndërkohë që reklama shtetërore janë në rënie për vite me radhë që nga viti 2012 kur këto reklama ishin në kulmin e tyre duke qenë se zinin rreth 10-15% të tregut të TV. Reklamimi i partive politike gjatë fushatës zgjedhore ka një ndikim shumë më të madh. Për shembull, të dhënat e analizuar nga BIRN në Shqipëri tregojnë se partitë kryesore politike nuk kanë deklaruar miliona euro të shpenzuara për reklama televizive gjatë fushatës për zgjedh-

41 Departament i Shtetit i ShBA-ve, Raporti për Shqipërinë 2021. Aksessuar më 3.05.2022. <https://bit.ly/3Qnlv0L>

42 Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt, "Letër e hapur për organizatat ndërkombëtare me shqetësime për lirinë e medias në Shqipëri". Aksessuar më 15.10.2021. <https://bit.ly/3xWfiskj>

43 Media Freedom Rapid Response, Raporti për vitin 2022. Aksessuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3aTNT5G>

44 Departament i Shtetit i ShBA-ve, Raporti për Shqipërinë 2021. Aksessuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3OlljNe>

45 Departament i Shtetit i ShBA-ve, Raporti për Shqipërinë për praktikën e të drejtave të njeriut 2021. Aksessuar më 3.05.2022. <https://bit.ly/3OhKZWL>

46 Komisioni Evropian, (2021), Raporti për Shqipërinë 2021, p.30. Aksessuar më 3.5.2022. https://ec.europa.eu/ neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

47 Albanian Media Institute, 2020, Advertising Market in Albanian Media. Aksessuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3tGF3yQ>

jet parlamentare të 25 prillit.⁴⁸ Duke përdorur të dhënat e monitorimit të mediave të publikuara nga Autoriteti i Medias Audiovizive, AMA, BIRN ka llogaritur se partitë politike në Shqipëri kanë transmetuar gjithsej pesë orë e 45 minuta reklama në televizione gjatë fushatës, nga data 26 mars deri më 24 prill dhe “pjesa e luanit në këto reklama i përkiste Partisë Socialiste, e cila kishte 47.4 për qind të të gjitha reklamave politike të transmetuara në televizion gjatë fushatës”.⁴⁹ Sipas kësaj analize, suksesi i Partisë Socialiste në zgjedhjet parlamentare mund t’i atribuohet pjesërisht “një fushatë masive reklamash në mediat elektronike para ditës së votimit, në të cilën ajo shpenzoi miliona euro.”⁵⁰

Në vitin 2021 në Shqipëri u mbajtën zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, por dispozitat që garantojnë transparencën e kushteve të reklamimit të fushatës nuk u respektuan gjithmonë nga mediat private gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të prillit 2021.⁵¹ Në përgjithësi, fondet shtetërore për reklama në mediat janë në rënie edhe për vitin 2021. Gjithsesi, mediat në mënyrë të tërthortë përfitojnë nga fondet, projektet apo favore të tjera që shteti mund t’u japë pronarëve dhe bizneseve të tyre, siç janë licencat, lejet e ndërtimit dhe përfitime të tjera që vijnë nga tenderët publikë. Pronarët e bizneseve të mediave i përdorën ato si mjete për të fituar favore nga qeveria apo aktorë të tjerë të fuqishëm. Varësia e mediave nga këto burime financimi ka bërë që politika e tyre editoriale të ndikohet dhe të jetë e njëanshme⁵² dhe në marrëdhënie simbiotike me politikën dhe biznesin. Në vitin 2021, një praktikë mjaft shqetësuese e mediave është edhe ajo e shantazhimit të bizneseve, partive apo individëve duke i kërcënuar me mbulim negativ mediatic.⁵³

A ka ndonjë lloj subvencionimi ose fonde për mediat për prodhimin e përmbajtjes mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?

Përveç transmetuesit publik që ka fonde të veçanta për programet për pakicat kombëtare, nuk ka asnjë subvencion apo fonde për mediat për të prodhuar përmbajtje mediatike me interes publik. Gazetarët, stafi i mediave dhe shoqatat e mediave kanë argumentuar nevojën për dhënie të subvencioneve të tilla për të mbështetur diversifikimin dhe larminë në programet e mediave

Cilat janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e pakicave kombëtare?

Ka dispozita ligjore për financimin e mediave në gjuhët e pakicave kombëtare për transmetuesin publik, të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare që njeh të drejtën e minoriteteve për të përdorur shtypin dhe mediat elektronike në gjuhën e tyre amtare, duke zbatuar rregullat e përcaktuara në ligjin për mediat, pa u diskriminuar në bazë të gjuhës së tyre, trashëgimisë etnike dhe kulturore. Gjithashtu, radiotelevizioni publik duhet të transmetojnë në një nga kanalet e tij lajme dhe programe kulturore në gjuhën e minoriteteve (Neni 20).⁵⁴ Në vitin 2021 nuk u hartua apo u zbatua asnjë politikë shtetërore në lidhje me pakicat dhe mediat.

A është e garantuar dhe e mbrojtur në mënyrë efikase autonomia dhe pavarësia e transmetuesit publik? A parashikon kuadri financiar pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e tij? A përfaqëson shoqërinë në përgjithësi organi mbikëqyrës i këtij transmetuesi?

Autonomia dhe pavarësia e Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), transmetuesit publik në Shqipëri, garantohej me ligj, por në praktikë janë mjaft të vështira. Organet drejtuese të RTSH nuk janë gjithmonë të pavarura nga partia në pushtet dhe procesi i zgjedhjes së tyre në përgjithësi është kontestuar vazhdimisht. Për shembull, në vitin 2021, Kuvendi zëvendësoi të gjithë anëtarët e bordit të RTSH-së, të cilëve u kishte mbaruar mandati, përfshirë edhe kryetarin, brenda majit të vitit 2021, duke e bërë në parim organin plotësisht funksional. Megjithatë, në atë kohë në parlament nuk kishte një opozitë reale, duke bërë që të lindnin kritikant për zgjedhjen e anëtarëve vetëm me mbështetjen e Partisë Socialiste në pushtet. Siç raporton edhe KE, në maj, përmes një procesi mjaft të nxituar, bordi drejtues shkarkoi drejtor-

48 “Partitë fshehën miliona euro shpenzime për propagandë elektorale në zgjedhje”, *Reporter.al*. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3zNCar7>

49 Likmeta, Besar. (2021). “Blic i reklamave televizive zgjedhore të partive politike në Shqipëri kalon pa u ndëshkuar”, *Balkan Insight*, për më shumë vizitoni. Aksesuar më 13.5.2022. <https://balkaninsight.com/2021/06/11/albanian-parties-election-tv-ads-blicz-goes-unsanctioned/>

50 Likmeta, Besar. (2021). “Blic i reklamave televizive zgjedhore të partive politike në Shqipëri kalon pa u ndëshkuar”, *Balkan Insight*, për më shumë vizitoni. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3tlraq7>

51 Misioni i Kufizuar i ODHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar, (2021). Aksesuar më 15.3.2022. <https://www.osce.org/files/f/documents/5/1/493687.pdf>

52 Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias 2019. Gjurmimi i zhvillimit të mediave të qëndrueshme të pavarura në botë. IREX, 2020. Aksesuar më 15.5.2021. <https://bit.ly/3MU8u7b>

53 Departamenti i Shtetit i ShBA-ve, Raporti për Shqipërinë për praktikën e të drejtave të njeriut 2021. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3xArzpx>

54 Ilda Londo, “Media shqiptare dhe standardet evropiane”, Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias, 2018, p. 28. Aksesuar më 15.5.2021. <https://bit.ly/39Ds0Hs>

in në detyrë, mandati i të cilit kishte skaduar në fillim të po atij muaji, pa shpallur thirrjen për drejtorin e ri, siç e kërkon ligji.⁵⁵ RTSH ka funksionuar pa drejtor të përgjithshëm nga maji deri në nëntor 2021, kur Këshilli Drejtues i RTSH-së zgjodhi z. Enkelejdi Joti si drejtor të ri të përgjithshëm të RTSH-së.⁵⁶

Për sa i përket financimit, kuadri financiar i RTSH-së bën të mundur pavarësinë e saj duke qenë se ky transmetues publik financohet nga publiku, kryesisht përmes një tarife të veçantë që paguhet nga çdo familje përmes faturës së energjisë elektrike. Megjithatë, menaxhimi dhe transparenca e fondeve kanë qenë të kufizuara. Për shembull, raportet financiare për vitin 2021 për RTSH nuk janë bërë ende publike siç kërkohet me ligj.⁵⁷ Gjithashtu, vendimet e Këshillit Drejtues të RTSH nuk publikohen më që nga muaji mars i vitit 2021. Nga ana tjetër, akuzat për korrupsion kanë shoqëruar përherë administrimin e fondeve të RTSH-së. Për shembull, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar konfirmoi në tetor 2021 vendimin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) për arrestimin e ish Drejtorit të Përgjithshëm të Radio Televizionit Kombëtar Shqiptar, Thoma Gëllçi, për shpërdorim detyre për një tender me vlerë rreth 708.000 euro.⁵⁸

A2 Efektet e Ligjit të Shpifjes te gazetarët

A janë dispozitat ligjore për shpifjen të rrepta dhe mbrojtëse për zyrtarëve të shtetit? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Në Shqipëri, dhe në kundërshtim me praktikat më të mira ndërkombëtare, shpifja është një kundërvajtje penale por që nuk dënohet me burg. Në Kodin Penal në fuqi shpifja përkufizohet si "Përhapja e qëllimshme e

thënieve, si dhe çdo informacion tjetër, duke e ditur se janë të rreme, që cenojnë nderin dhe dinjtetin e personit." Sipas këtij Kodi shpifja dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion e pesëqind mijë lekë. Në vitin 2012, Kodi Penal u rishikua dhe u hoq dënimi me burg deri në dy vjet për shpifjen.⁵⁹ Edhe Kodi Civil ka dispozita për shpifjen.

Sa procese gjyqësore janë hapur kundër gazetarëve nga zyrtarë të shtetit dhe politikanë gjatë vitit të kaluar?

Në raporte të ndryshme theksohet se janë bërë rreth 20 padi kundër gazetarëve nga politikanë, biznesmenë dhe zyrtarë të tjerë.⁶⁰ Megjithatë, edhe pse Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i kemi dërguar një kërkesë për informacione publike, nuk kemi marrë shifra të sakta nga kjo gjykatë.

Sa të motivuara politikisht janë vendimet e gjykatave ndaj gazetarëve? Çfarë lloj dënimesh janë dhënë?

Ka mungesë transparence në vendimet e gjykatave ndaj gazetarëve, nëse ka vendimet të tilla, dhe janë evidentuar edhe vonesa në gjykimin e çështjeve. Për vitin 2021 në Shqipëri nuk janë dhënë dënime me burg (ndaj gazetarëve). Megjithatë, mungojnë të dhënat për dënime për raste të caktuara për vitin 2021.

A e njohin gjykatat mekanizmin vetë- rregullues të krijuar (nëse ka)? A e pranojnë ato si të vlefshëm një përgjigje, korrigjim ose falje të botuar ose shpërndarë?

Nuk ka një bazë të plotë të dhënash për vendimet e gjykatave ndaj mediave në mënyrë që të jemi në gjendje të vlerësojmë plotësisht vlefshmërinë e mekanizmave vetëregullues në procedurat ligjore. Sipas Kodit Civil, në rast se një person shpallet fajtor për publikimin e informacionit të pasaktë e të rremë për një person tjetër, gjykata urdhëron që ky person të kërkojë falje publike. Prandaj, në këtë drejtim, kjo lloj praktike njihet edhe me ligj.

55 Komisioni Evropian, 2021. Progres Raporti për Shqipërinë 2021, për më shumë vizitoni, p.31. Aksuesar më 15.3.2022. https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/albania-report-2021_en

56 Enkelejdi Joti më parë mbante postin e Drejtorit Ekzekutiv në Top Media, ndofta media më e madhe në vend, për 12 vite me radhë, nga viti 2003 deri në dhjetor 2015 kur dha dorëheqjen. Nga viti 2017 ishte Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Spitalore Universitare të Tiranës "Nënë Tereza".

57 Sipas ligjit nr. 97/2013, "Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë", Neni 7 i Ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" RTSH publikon në fund të çdo viti Raportin Ekonomiko-Financiar të veprimtarisë së tij. Ky raport i paraqitet Komisionit të Medias dhe Kuvendit të Shqipërisë, përpara se të bëhet publik në faqen zyrtare www.rtsht.al. Raporti i vitit 2021 nuk është publikuar ende.

58 Fjori Sinoruka, "Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë 'e priste' arrestimin e drejtorit të TV publik", 2021, Aksuesar më 15.1.2022. <https://bit.ly/3MZFkDJ>

59 Ermal Nazifi dhe Michael J. Oghia. "Qeverisja me internet në Shqipëri dhe roli i saj në lirinë e medias"; Tiranë: Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ në Shqipëri, 2020. Aksuesar më 15.3.2021. <https://bit.ly/3Om3zNu>

60 Komisioni Evropian. (2021). Raporti për Shqipërinë 2021. https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/albania-report-2021_en/ <https://www.state.gov/reports/2021-country-reports-on-human-rights-practices/albania>

Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin e shpifjes? A dekurajohen ata për të hetuar e për të bërë shkrime kritike?

Në mënyrë të veçantë, gazetarët e pavarur dhe ekspertët e mediave, gazetarët investigativë dhe ata kritikë argumentojnë se praktikata e shpifjes në Shqipëri dhe debati i vazhdueshëm i Kryeministrit për të rregulluar më tej përmbajtjen mediatike po ndikojnë negativisht në gazetarinë e pavarur profesionale dhe cilësore në Shqipëri.⁶¹ Viti 2021 ishte mjaft i vështirë për gazetarët për shkak të kërcënimeve, ngacmimeve dhe kushteve të tmerrshme të punës.⁶² Gazetarët raportojnë se shpesh praktikojnë vetë-censurën për të shmangur fushatat e shpifjeve në internet, presionet në redaksi dhe ngacmimet nga aktorë të tjerë.

A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media

A është rregulluar pluralizmi politik në media me ndonjë ligj të veçantë për mediat jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet e transmetuesit të shërbimeve publike dhe cilat janë ato të transmetuesve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore?

Pluralizmi politik në media është i rregulluar me ligj të veçantë për Transmetuesin e Shërbimit Publik dhe për procesin zgjedhor. Pavarësisht kësaj, ka parime të përgjithshme të paanshmërisë që rregullojnë punën e operatorëve të shërbimit të mediave, ku ligji thotë se operatorët e transmetimeve audiovizive mund të transmetojnë veprimtarinë e forcave politike, por ato duhet ta bëjnë këtë gjë pa treguar njëanshmëri politike. Transmetuesi i Shërbimit Publik është i detyruar të ruajë pluralizmin politik jashtë procesit zgjedhor, por mediat private nuk janë të detyruar me ligj për një gjë të tillë. Ligji për mediat audiovizive thotë se Bordi i Transmetuesit të Shërbimit Publik duhet të monitorojë dhe garantojë paanshmërinë e informacionit. Po ashtu, dispozita për paanshmërinë janë përfshirë edhe në Statutin dhe Politikën Editoriale të TSHP-së, ndërkohë që udhëzimet editoriale të këtij transmetuesi bëjnë thirrje për pluralizëm pikëpamjeje/opinionesh dhe raportim të balancuar. Megjithatë, nuk ka raporte nga RTSH apo AMA se si është arritur ky pluralizëm dhe deri në ç’nivel.

61 Përfundime të diskutimeve në fokus grupe në mars 2022.

62 Hoxhaj, A. (2022). *Nations in Transit, Albania 2022*. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3Oqxsik>

A është i detyruar autoriteti rregullator të monitorojë dhe mbrojë pluralizmin politik përtej procesit zgjedhor?

Për vitin 2021 nuk ka pasur ndryshime në këtë drejtim. Siç është raportuar edhe më parë, ligji për mediat audiovizive përcakton se autoriteti rregullator, AMA, mbikëqyr paanshmërinë, objektivitetin dhe tërësinë e informacionit audiovizive.⁶³ Autoriteti rregullator nuk mbikëqyr gjendjen e pluralizmit politik tek mediat përtej procesit zgjedhor, përveç Transmetuesit të Shërbimit Publik. AMA publikon rregullisht raporte monitorimi në lidhje me mbikëqyrjen e përmbajtjes dhe të shpeshësisë, por nuk është e fokusuar vetëm te pluralizmi politik.

A kanë akses të drejtë dhe të barabartë te mediat partitë politike dhe kandidatët e tyre përtej procesit zgjedhor?

Partitë politike dhe kandidatët e tyre nuk kanë akses të drejtë dhe të barabartë te mediat. Gjatë procesit zgjedhor të vitit 2021, partia në pushtet pati një mbulim më pozitiv në media.⁶⁴ Jashtë proceseve zgjedhore nuk ka garanci për akses të drejtë dhe të barabartë në media. Megjithatë, në përgjithësi, partitë dhe aktorët kryesorë politikë gëzojnë akses të konsiderueshëm në media. Ajo që është shqetësuese në Shqipëri është praktika e partive politike dhe politikanëve, si dhe zyrtarëve publikë të nivelit të lartë që veprojnë si “redaksi” duke qenë se u ofrojnë mediave pamje të redaktuara dhe të përgatitura paraprakisht të aktiviteteve të tyre dhe mediat thjesht e transmetojnë ose publikojnë materialin siç e marrin atë.

Për shembull, “Forumi i Mendimit të Lirë” monitoroi transmetimin e lajmeve të gatshme të sjella nga zyrat e shtypit të qeverisë, ministrive, Bashkisë së Tiranës, opozitës dhe institucioneve të tjera në tre televizione kombëtare, përkatësisht: Top Channel, TV Klan dhe RTSH gjatë muajve mars-prill 2020. Nga gjetjet e këtij monitorimi rezultoi se këto tre media kombëtare bënë një pasqyrim relativisht intensiv të aktiviteteve me produkte të sjella gati në redaksi nga qeveria, kryetari i bashkisë dhe opozita.⁶⁵ E njëjta praktikë u vu re edhe për vitin 2021 dhe madje u intensifikua edhe më shumë.

63 Ligji Nr. 97/2013, datë 4.3.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Aksesuar më 15.3.2021. <https://bit.ly/3N0hPL1>

64 Misioni i Kufizuar i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raporti Përfundimtar, (2021). Aksesuar më 15.03.2022. <https://www.osce.org/files/f/ documents/5/1/493687.pdf>

65 Citizen Channel, 2021, Monitorim: Mediat kombëtare, shpërndarëse e informacionit të gatshëm nga qeveria dhe institucionet shtetërore, për më shumë vizitoni. Aksesuar më 15.3.2022. <https://bit.ly/3O4hmlU>

Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ monitoron mediat elektronike dhe shtypin?

Koha televizive dhe aksesit falas ofrohen vetëm në transmetuesin publik gjatë zgjedhjeve. Në rast se stacionet televizive private vendosin të mbulojnë fushatën elektorale në edicionin e tyre të lajmeve, shpërndarja e kohës së transmetimit të tyre rregullohet me ligj, ndërsa reklamata janë me pagesë. Televizionet private kanë detyrimin të garantojnë të njëjtën tarifë për çdo parti/aktor. Kodi Zgjedhor parashikon që transmetuesit duhet të ndajnë kohë të barabartë transmetimi për dy partitë më të mëdha në vend dhe se së bashku këto parti nuk duhet të marrin më shumë se dyfishin e kohës së transmetimit të partive më të vogla politike. AMA monitoron mediat audiovizive për mbulimin e fushatës zgjedhore. Nuk ka monitorim të medias së shkruar. AMA nuk monitoron mediat elektronike, madje as për mbulimin e fushatës elektorale. Mandati aktual i AMA-s përfshin vetëm mediat audiovizive. Edhe ODIHR dhe OJQ-të shqiptare ndërmarrin procese të pavarura monitorimi.

A kanë akses të drejtë e të barabartë te mediat partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatave zgjedhore?

Ligji parashikon akses të drejtë e të barabartë te mediat për partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatave zgjedhore. Pavarësisht dispozitave ligjore, grupe të ndryshme aktorësh politikë përfaqësohen në mënyrë të njëanshme dhe të pabarabartë, duke favorizuar qarta-zi disa aktorë politikë ndaj të tjerëve.⁶⁶ Ndër të tjera, nga konstatimet e AMA-s u evidentua se Partia Socialiste kishte marrë vazhdimisht më shumë mbulim se konkurrentët e tjerë në fushatën elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2021. Po ashtu, më 27 maj, bazuar në gjetjet e monitorimit të AMA-s, Komisioneri gjobiti transmetuesin publik me 2 milionë lekë për shkeljen e heshtjes zgjedhore. Gjithsesi, edhe pse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve konstatoi se disa kanale televizive nuk kishin caktuar ndarjen e kohës të përcaktuar me ligj për partitë gjatë fushatës elektorale, në këtë drejtim nuk u vendos asnjë sanksion, përveç gjobës ndaj RTSH-së.⁶⁷ Mbulimi i partive të tjera joparlamentare varet nga dëshira e redaktorëve dhe nuk mund të jetë më i madh se mbulimi që u bëhet partive më të vogla parlamentare. Kjo qasje diskriminuese ndaj partive më të vogla bie në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare. Gjithashtu, mungesa e rregullave të qarta për

ndarjen e kohës për koalicionet solli si rezultat interpretime të ndryshme. Dispozitat që përcaktojnë transparencën e kushteve të reklamimit të fushatës nuk u rreptuan gjithmonë nga mediat private.⁶⁸

Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, Neni 84.1 i Kodit Zgjedhor ende lejon që pamjet e regjistruara paraprakisht të prodhuara nga partitë të transmetohen gjatë edicioneve të lajmeve. Kjo praktikë e gjatë dhe e përhapur e partive kryesore politike dhe zyrtarëve publikë për t'i ofruar mediave filmime të regjistruara më parë ose të drejtpërdrejta të aktiviteteve të tyre është kritikuar mjaft ashpër. Duke interpretuar ngushtë ligjin dhe rregulloret e KQZ-së, transmetuesit shpesh zgjedhën të mos merrnin pjesë në veprimtaritë e fushatës, gjë që rezultoi në mungesë të mbulimit gjithëpërfshirës dhe objektiv të konkurrentëve dhe bëri të paqartë ndarjen mes përmbajtjes editoriale dhe reklamës politike. Kjo praktikë bie në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.⁶⁹

Sipas raportit të OSBE ODIHR për zgjedhjet e përgjithshme, edhe pse KQZ i kërkon mediave të bëjnë mbulim të balancuar gjinor të fushatës, ky institucion nuk ka kontroll se kë propozon një parti politike për të marrë pjesë në emisione/debatet televizive. Në lajmet dhe emisionet e aktualitetit, siç raportohet nga ODIHR, bazuar në të dhënat e monitorimit të AMA-s, kandidatet femra dhe aktore të tjera femra morën 19 për qind të mbulimit dhe edhe më pak në mediat online të monitoruara. Po ashtu, të dhënat e analizuara nga BIRN në Shqipëri tregojnë se “gjatë fushatës për zgjedhjet e 25 prillit, faqet online të mediave shqiptare i kushtuan shumë më tepër vëmendje Partisë Socialiste në pushtet, liderit të saj Edi Rama dhe meshkujve, sesa partive më të vogla apo kandidatëve femra.”⁷⁰ Të dhënat e AMA-s të analizuara nga BIRN tregojnë se transmetuesit në Shqipëritë të gjithë spektrit shkelën Kodin Zgjedhor duke i kushtuar më shumë kohë transmetimi socialistëve në pushtet sesa rivalët e tyre kryesorë, demokratëve, duke neglizhuar kështu edhe partitë më të vogla. AMA rekomandoi sanksione ndaj disa mediave, por Komisioneri vendosi të gjobisë vetëm RTSH-në për thyerjen e ‘heshtjes zgjedhore’ në prag të votimit.⁷¹

68 OSBE/ODHIR, Raport për zgjedhjet parlamentare në Shqipëri, 2021. Aksesuar më 15.2.2022. <https://www.osce.org/files/documents/5/1/493687.pdf>

69 Po aty, p. 22.

70 Likmeta, Besar. (2021). “Vetëm burra: Mediat në zgjedhjet në Shqipëri të fokusuar vetëm tek liderët meshkuj”, *Balkan Insight*. Accessed, 13.5.2022. <https://bit.ly/3tEgERx>

71 Likmeta, Besar. (2021). “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën një sy qorr për njëanshmërinë në transmetime”, *Balkan Insight*. Accessed, 13.5.2022. <https://bit.ly/3Hyc3ij>

66 Po aty.

67 Likmeta, Besar. (2021). “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën një sy qorr për njëanshmërinë në transmetime”, *Balkan Insight*. Accessed, 13.05.2022. <https://bit.ly/3y1818D>

A4 Liria e punës dhe shoqatës së gazetarëve – garancitë ligjore dhe praktika

A u duhet gazetarëve të licencohen nga shteti për të ushtruar profesionin? A ka pasur përpjekje gjatë vitit të kaluar për të prezantuar leje të tilla nga shteti?

Nuk ka pasur ndryshime në këtë drejtim në vitin 2021. Në aspektin pozitiv, gazetarët në Shqipëri nuk kanë nevojë të jenë të licencuar nga shteti për të ushtruar profesionin.

A u është refuzuar gazetarëve e drejta për të raportuar një ngjarje të caktuar për shkak të mosakreditimit?

Ka raste kur gazetarëve iu refuzohet e drejta për të raportuar nga një vendngjarje për arsye se nuk kanë akreditim, veçanërisht në gjykata dhe institucione të tjera publike. Në vitin 2021, ashtu si në periudhën e kaluar të raportimit, kufizimet anti-COVID-19 u përdorën si justifikim për të penguar gazetarët të raportonin në pak raste, siç raportohet nga vetë këta të fundit. Megjithatë, problemi më i madh në Shqipëri është se numri i ngjarjeve, konferencave për shtyp dhe platformave të tjera ku gazetarët mund të marrin pjesë dhe të bëjnë pyetje është në rënie, duke pasur parasysh se Qeveria dhe partitë politike përgatisin material të gatshme dhe mediat thjesht i transmetojnë ato. Ka pasur raste kur gazetarëve u është refuzuar e drejta për të raportuar një ngjarje gjatë periudhës së zgjedhjeve apo edhe në raste të tjera. Edhe në konferencat për shtyp dhe ngjarje të tjera të Kryeministrit, të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës ose të zyrtarëve të tjerë të qeverisë, ka raste që gazetarëve nuk u lejonet të marrin pjesë në këto takime për të bërë pyetje.⁷² Nga ana tjetër, reporterët dhe gazetarët që punojnë për media të pavarura apo ato investigative dhe kritike diskriminohen rregullisht kur kërkojnë informacione apo komente nga ministrit.⁷³

Një shqetësim i madh në akreditimin e gazetarëve në vitin 2021 ishte përpjekja e Parlamentit për të prezantuar një rregullore të re që pengon lirinë e lëvizjes dhe të raportimit të gazetarëve nga brenda ndërtesës dhe të mbledhjeve të komisioneve parlamentare. Në qershor 2021, Kuvendi nxori një rregullore të ndryshuar për Akreditimin, Akomodimin dhe Orientimin e Masedias në Kuvend, e cila u miratua pa u konsultuar më parë me

gazetarët dhe shoqatat e punonjësve të medias.⁷⁴ Kjo lëvizje e Kuvendit hasi në kritika të forta nga gazetarët, organizatat e pavarura të medias dhe aktorët ndërkombëtarë duke ngritur shqetësime për efektin e rregullores së re në mundësinë e gazetarëve dhe punonjësve të medias për të raportuar dhe për rënien e nivelit të transparencës së Parlamentit.⁷⁵ Pas një kundërshtimi të tillë, Kuvendi e ndryshoi rregulloren pas një seance konsultimi me gazetarët, rregullore që hyri në fuqi në shtator të 2021.

A janë gazetarët të organizuar në shoqata profesionale dhe nëse po në ç'mënyrë? A ka presione mbi organizatën e tyre ose mbi anëtarët e organizatës?

Gazetarët janë të organizuar në shoqata profesionale, por këto shoqata nuk janë të konsoliduara dhe kanë mangësi në burime dhe kompetenca. Unioni i Gazetarëve Shqiptarë ka rreth 1,200 anëtarë dhe ka ngritur degë në 10 qytete të Shqipërisë. Shoqata e Gazetarëve Profesionalistë Shqiptarë ka rreth 220 anëtarë dhe një bord me 12 gazetarë. Është anëtar i asociuar i Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve. Në vitin 2021, u krijua Lëvizja e Gazetarëve si një nismë e gazetarëve profesionalistë në Shqipëri për të krijuar dhe mbrojtur statusin e gazetarit. Janë ngritur shqetësime për kërkesat e tyre, të cilat mund të çojnë në licencimin e gazetarëve dhe krijimin e një regjistri kombëtar nga qeveria. Shoqata e Gazetarëve Profesionalistë Shqiptarë është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve, e cila përfshin Federatën Evropiane të Gazetarëve.⁷⁶ Asnjë presion ndaj shoqatave nuk u raportua në vitin 2021.

A janë gazetarët të organizuar në sindikata dhe, nëse po, si? A ka presione mbi drejtuesit e sindikatave dhe anëtarët e tjerë? A janë gazetarët të lirë të bëhen anëtarë të sindikatave?

Nuk ka sindikata të gazetarëve në Shqipëri. Nuk ka pasur asnjë nismë të re në 2021 për të krijuar një sindikatë gazetarësh përveç Lëvizjes së Gazetarëve si një nismë e gazetarëve profesionalistë në Shqipëri për të krijuar dhe mbrojtur statusin e gazetarit. Sindikatat e tjera në Shqipëri nuk kanë një seksion të veçantë për punon-

⁷² Intervistë me profesionistë të mediave, mars 2021.

⁷³ Media Freedom Rapid Response, raporti për vitin 2021, p. 38. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3QvI9PM>

⁷⁴ Instituti Ndërkombëtar i Shtypit, Gazetarët e akredituar shqiptarë do të përballen me kufizime të padrejta aksesi në Parlament, 2021. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3yQdbbs>

⁷⁵ Safe Journalists Network, Rregullorja e re e Kuvendit të Shqipërisë mund të vë në rrezik lirinë e mediave, 2021. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3tHrCYL>

⁷⁶ Një listë e anëtarëve aktualë është e disponueshme këtu <https://europeanjournalists.org/blog/2015/12/19/albania/>

jësit e medias dhe gazetarët. Nuk ka sindikatë as tek Transmetuesi i Shërbimit Publik.

A ka ndonjë Këshill Shtypi dhe si është i organizuar ai? A u bëhen presione përfaqësuesve të këtij Këshilli Shtypi?

Siç u raportua edhe vitin e kaluar, Këshilli Shqiptar i Medias është një organizatë e pavarur e gazetarëve, e regjistruar në 2015 si OJQ në formën e një shoqate që ka si synim një media më etike, profesionale dhe më të pavarur. Anëtarët themelues të Këshillit janë më shumë se tridhjetë gazetarë shqiptarë nga TV, media e shkruar dhe online. Këshilli Shqiptar i Medias përqipet të nxisë zbatimin e Kodit të Etikës⁷⁷ në media në Shqipëri, publikuar në 2018 nga Instituti Shqiptar i Medias. Në vitin 2020, Këshilli Shqiptar i Medias krijoi Aleancën për Media Etike si një mekanizëm vetë-rregullimi dhe prezantoi “Udhëzimet Etike për Gazetarinë Online”.⁷⁸ Aleanca për Media Etike është një grup vullnetar i mediave shqiptare e angazhuar për zbatimin rigoroz të Kodit të Etikës për Gazetarët.⁷⁹ Aleanca synon të zbatojë një mekanizëm funksional vetërregullues duke marrë dhe shqyrtuar ankesat nga publiku në lidhje me shkeljet etike të mediave online. Aleanca u ofron mediave online rekomandime, të cilat, gjithsesi, nuk janë të detyrueshme. Në faqet e tyre online shfaqet logoja e aleancës si vullë e mediave etike.⁸⁰

A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve

Si garantohet nga legjislacioni konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve? Në cilat rrethana mund t'i nënshtrohet kufizimeve e drejta për të mbrojtur burimet e tyre? A garantohet me Kushtetutë e drejta për mbrojtjen e burimeve?

Nuk ka pasur ndryshime ligjore në këtë drejtim në vitin 2021. Mbrojtja e burimeve konfidenciale të informacionit është një nga parimet themelore të punonjësve të medias, sipas dispozitave të ligjit për mediat. Veç

kësaj, Neni 159 i Kodit të Procedurës Penale i përfshin gazetarët mes profesioneve që nuk janë të detyruar ta zbulojnë burimin e informacionit, duke e konsideruar atë sekret profesional. Megjithatë, me vendim gjykatë mund të provohet se burimi i informacionit është provë themelore dhe gazetarëve mund t'u kërkohej zbulimi i tij. Gazetarët kanë detyrimin etik që të mos zbulojnë burimet e tyre të informacionit.⁸¹ Sipas Kodit të Etikës së medias në Shqipëri, “Gazetarët nuk duhet të bëjnë publik emrin e një personi që ka dhënë informacion në konfidencialitet, veç rasteve kur personi në fjalë ka dhënë pëlqimin shprehimisht.”⁸² Gjykata mund t'u kërkojë gazetarëve me anë të një urdhri me shkrim të zbulojnë burimin konfidencial të informacionit nëse është në interes të publikut.

A e respektojnë autoritetet konfidencialitetin e burimeve të gazetarëve? A ka shembuj ku gazetarët urdhërohen të zbulojnë burimet e tyre dhe a arsyetohet ky urdhër me mbrojtjen e interesit publik?

Siç është raportuar edhe më parë, në Shqipëri konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve është sfidë më vete. Raportet e vitit 2021 nxjerrin në pah rrezikun e sigurisë së gazetarëve dhe burimeve të tyre nga krimi i organizuar dhe paaftësia e shtetit për t'i mbrojtur ata.⁸³ Në veçanti, për shkak të lidhjeve shoqërore dhe familjare dhe presioneve të ndryshme në komunitetet e vogla, mediat lokale e kanë të vështirë t'i mbrojnë burimet e tyre të informacionit.⁸⁴ Në vitin 2021 pati një rast të madh kur autoritetet i kërkuan një medie (Lapsi.al) për të bërë të ditur burimet. Në prill 2021, Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar (SPAK) urdhëroi gazetarët Andi Bushati dhe Armand Shkullaku të dorëzonin një bazë të dhënash që përmbante të dhënat personale të më shumë se 910,000 votuesve në Shqipëri. Kur ata e refuzuan kërkesën e prokurorisë, duke arsyetuar e shprehur shqetësimet që kishin në lidhje me konfidencialitetin e burimit, Gjykata e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në Tiranë urdhëroi sekuestrimin e të gjitha pajisjeve të medias së tyre, LAPSI.al, si dhe celularët, serverët, kompjuterët dhe disqet USB.⁸⁵ Kjo u kritikua ashpër si përpjekje për të frikësuar gazetarët. Urdhri i gjykatës

77 Kodi i Etikës së Gazetarit mund të gjendet i plotë në adresën: <https://ksh.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

78 Udhëzime Etike për Gazetarinë Online gjenden në adresën: <https://ksh.al/wp-content/uploads/2018/04/UDH%20I%20ETIKES-SE-GAZETARIN%20ONLINE-3.pdf> <https://ksh.al/wp-content/uploads/2018/04/ETHICAL-GUIDELINES-FOR-ONLINE-JOURNALISM-7.pdf>

79 Për më shumë informacion për Aleancën për Media Etike vizitoni: <https://aleancaetike.media/about-us/>

80 Bino, B. (2021). “Media Freedom in Albania: Such a Frail Thing”, p. 9-15. Aksesuar më 3.05.2022. <https://bit.ly/3O2RMUJ>

81 Për më shumë informacion: <https://www.reporter.al/manualidreitesise/BURIMET%20DHE%20GAZETARI.html>

82 Kodi i Etikës së Gazetarit mund të gjendet i plotë në adresën: <https://ksh.al/kodi-i-etikes-se-gazetarit/>

83 Reporterët pa Kufi, Indeksi i Lirisë së Shtypit 2022, Albania. Aksesuar më 4.5.2022. <https://rsf.org/en/country/albania>

84 Intervistë me reporter vendas, mars 2022.

85 Mësoni më shumë në bazën e të dhënave të Gazetarëve të Sigur <https://safejournalists.net/portfolios/state-pressure-and-physical-assault-on-albanian-journalists/> dhe në bazën e të dhënave të Media Freedom Rapid Reponse https://www.mapmf.org/uploads/MFRR-Monitoring-Report_2021.pdf

ishte pjesë e një hetimi për shkeljen e supozuar të të dhënave, por grupet e të drejtave të medias kanë kritikuar SPAK-un në Shqipëri, duke thënë se urdhri ishte i motivuar politikisht dhe në kundërshtim me parimet e fjalës së lirë.⁸⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka reaguar menjëherë duke kërkuar pezullimin e masës për arsye të lirisë së fjalës së gazetarit dhe mbrojtjes së burimeve konfidenciale. Në fillim të majit, gjyqësori shqiptar mori parasysh kërkesën e GJEDNJ.⁸⁷

A ka pasur sanksione ndaj gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit të tyre?

Në vitin 2021, nuk u regjistruan raste sanksionesh ndaj gazetarëve që kanë refuzuar të zbulojnë identitetin e burimit të tyre.

A ndjehen të lirë gazetarët të kërkojnë akses dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?

Ashtu si edhe në periudhën e mëparshme të raportimit, në 2021 siguria e gazetarëve për të aksesuar dhe mbajtur kontaktet me burimet e informacionit bëhet më e vështirë nga problemet në përgjithësi me sigurinë e gazetarëve dhe kushtet e tyre të punës. Gazetarët që mbulojnë krimin e organizuar dhe gazetarët investigativë hasin më shumë vështirësi gjatë kërimit të aksesit dhe mbajtjes së kontakteve me burimet e informacionit.

A6 Mbrojtja e së drejtës për akses tek informacioni

Cilat janë rregullat ligjore për akses tek informacioni dhe dokumentet zyrtare që kanë lidhje me gazetarët?

Aksesi tek informacioni dhe transparenca e institucioneve publike shqiptare rregullohen nga Ligji Nr. 119/2014, 'Për të Drejtën e Informimit.' Ligji përcakton kërkesat për transparencë nga autoritetet publike, dispozitat për kërkesa për të drejtën e informimit dhe mekanizmat e monitorimit. Nëse autoritet publik dështon ose refuzon të japë informacionin e kërkuar pa dhënë arsye, personi që kërkon informacionin ka të drejtë të paraqesë

një ankesë te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, i cili mund të gjobisë autoritetin publik ose ta detyrojë atë të japë informacionin e kërkuar. Megjithatë, autoritetet publike mund të mos e japin informacionin e kërkuar, nëse ky informacion ka të bëjë ose ndikon negativisht në sigurinë kombëtare, sekretet tregtare, të drejtën e privatësisë, të drejtën e autorit, marrëdhëniet ndërqeveritare, politikatat monetare dhe fiskale, vazhdimin e hetimeve penale ose administrative dhe konsultimet ndërqeveritare për zhvillimin e politikave publike.⁸⁸ Pavarësisht këtyre kufizimeve, ligji thotë se informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Gjithsesi, dispozita për "interesi publik", është e papërcaktuar, duke u dhënë kështu institucioneve publike liri të konsiderueshme për të kufizuar ose refuzuar me ligj dhënien e informacionit.⁸⁹ Megjithatë, për të hedhur dritë mbi këtë të drejtë mund të përdoret jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

A i përdorin këto rregulla gazetarët? A i respektojnë pa vonesa këto rregulla autoritetet?

Kërkesa për marrje informacioni sipas Ligjit për të Drejtën e Informimit është instrumenti kryesor që kanë në dispozicion gazetarët për të marrë informacione. Megjithatë, kjo do të thotë që gazetarëve do t'u duhet të presin 10 ditë pune që është afati maksimal me ligj që u jep institucioneve për t'iu përgjigjur kërkesës për informim.⁹⁰ Kjo mund të shkaktojë vonesa në raportimin e gazetarëve. Prandaj, këta të fundit priren të përdorin burime të tjera informacioni. Po ashtu, edhe institucionet publike priren të përdorin afatin më të gjatë të mundshëm që u jep ligji për t'iu përgjigjur kërkesave; madje i vonojnë përgjigjet për to ose japin informacione dhe të dhëna që janë të vështira për t'u përdorur. Raporti i KE-së konfirmon shqetësimet e gazetarëve për aksesin e kufizuar tek informacionet dhe të dhënat në lidhje me kontratat e prokurimit, auditimet dhe pagat e zyrtarëve dhe joefikasitetin e mekanizmave në fuqi duke qenë se vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit nuk janë të detyrueshme për zyrtarët e administratës publike.⁹¹

86 Zëri i Amerikës, për më shumë vizitoni <https://bit.ly/3HzlqHf> (Aksesuar më 4.05.2022).

87 Balcanicaucaso, 2022, "Partitë Politike Shqiptare po bëjnë gazetarinë e tyre". Aksesuar më 4.5.2022. <https://bit.ly/3MV5wiU>

88 Neni 17, Ligji për të drejtën e informimit. 119/2014, Aksesuar më 24.6.2021. https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf

89 Westminster Foundation for Democracy dhe IDM, "Pjesëmarrja e Shoqërisë Civile në Vendimmarrje në Shqipëri". <https://bit.ly/3OitlNi>

90 Neni 15, Ligji për të drejtën e informimit. 119/2014, Aksesuar më 24.6.2021. https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf

91 Komisioni Evropian. (2021). Raporti për Shqipërinë 2021, p. 30. Aksesuar më 3.5.2022. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Në shtator 2021, qeveria shqiptare njoftoi ngritjen e një Agjencisë re për Mediat dhe Informim (AMI) që do të centralizonte në një agjenci të vetme marrëdhëniet me publikun të institucioneve të qeverisë dhe informimin e publikut.⁹² Organizatat e shoqërisë civile, shoqatat e mediave dhe organizatat ndërkombëtare për lirinë e shtypit tashmë kanë shprehur shqetësime për ndikimin e AMI-t në kufizimin e informimit publik.⁹³ Aktualisht, marrja e informacionit publik konsiderohet si pengesë kryesore për gazetari cilësor, veçanërisht për mediat kritike dhe investigative. Zbatimi i kufizuar i kuadrit ligjor për lirinë e informimit, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik, kulturës së fshehtësisë dhe ruajtjes së informacionit publik, si dhe mekanizmave të kufizuar për zbatimin e masave të llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve qeveritare, ndikon drejtpërdrejt në cilësinë dhe pavarësinë e raportimit.⁹⁴

A janë përgjithësisht transparente autoritetet shtetërore? A krijojnë ato marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe të paanshme me mediat apo tentojnë të punojnë në fshehtësi? A i trajtojnë institucionet shtetërore me preferencë mediat politikisht miqësore me ta?

Edhe pse në parim, Shqipëria ka një ligj të mirë për të drejtën e informimit të hartuar në konsultim edhe me shoqërinë civile dhe me mbështetje nga BE, në praktikë transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike janë të dobëta. Duke marrë parasysh kontekstin politik në vend me praktika të centralizuara të qeverisë dhe përqendrimin e informacionit në shumë pak duar, nivelin e ulët të transparencës dhe llogaridhënies, proceset e mangëta të konsultimeve dhe mjedisit tejet të polarizuar politik⁹⁵, në praktikë është mjaft e vështirë të arrihen marrëdhënie vërtetë të hapura jodiskriminuese të autoriteteve publike me qytetarët si dhe proces politik me pjesëmarrje dhe të bazuar në informacion.

Në prill, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale propozoi ndryshime në ligj, të cilat do t'i jepnin më shumë autoritet Komisionerit për të detyruar publikimin e informacionit nga institucionet publike. Deri në maj 2022 këto ndryshime ishin në proces konsultimi. Kjo erdhi si pasojë e një numri rekord prej 992 ankesash ndaj institucioneve shtetërore gjatë 2021 për mosdhënie informacioni të kërkuar nga mediat, shoqëria civile, dhe publiku. Pas

një rritje prej 39% të ankesave në krahasim me një vit më parë, Komisioneri vendosi në favor të 700 prej këtyre ankesave.⁹⁶

A janë transparente gjykatat? A sigurohet akses i medias tek procedurat ligjore në mënyrë jo-diskriminuese dhe pa kufizime të panevojshme?

Nuk ka pasur ndryshime të mëdha në vitin 2021. Me reformën kryesore gjyqësore në proces e sipër, akses i medias te proceset ligjore sigurohet përgjithësisht në mënyrë të paanshme dhe pa kufizime sipas parashikimeve të ligjit. Në tetor 2021 Gjykata e Posaçme u mbylli dyert gazetarëve me pretekstin e Covid-19 edhe pse masat kundër përhapjes së pandemisë ishin lehtësuar. Po ashtu, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) njoftoi se që nga 19 nëntori gazetarët do të lejoheshin të ishin të pranishëm në seancat dëgjimore pas plotësimit të një aplikimi akreditimi. Megjithatë, formulari i akreditimit që iu dërgua mediave i shqetësoi jo pak redaksitë e tyre. Duke përdorur mbrojtjen e të dhënave personale si mburojë, ky dokument synon të diktojë se çfarë mund të raportojnë gazetarët nga takimet e KLP dhe çfarë është e ndaluar të raportohet, duke e kthyer kështu atë në një instrument para-censurimi. Edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) imponoi në 2021 kufizime për hyrjen në seancat e tij dëgjimore, të cilat duhet të jenë të hapura.⁹⁷

A sigurohet pjesëmarrja e publikut në punimet e Kuvendit? A ka kufizime ndaj gazetarëve për të ndjekur punën e Kuvendit?

Në 2 qershor 2021, Byroja e Kuvendit të Shqipërisë publikoi një rregullore të amenduar për Akreditimin, Akomodimin dhe Orientimin e Masmedias pranë Kuvendit. Këto rregulla, që u miratuan pa konsultimin me shoqatat dhe organizatat e gazetarëve dhe punonjësve të medias, shoqërinë civile, apo aktorë të tjerë të rëndësishëm, do të hynin në fuqi në shtator 2021. Këto kufizime ndaj lirisë së lëvizjes do të ndikojnë negativisht në aftësinë e gazetarëve dhe punonjësve të mediave për të raportuar dhe do të ulin nivelin e transparencës së Kuvendit. Gazetarët e akredituar nga mediat private do të mund të raportojnë vetëm nga një redaksi e caktuar dhe nuk do të mund të ndjekin dhe raportojnë drejtpërdrejt nga sallat ku mbahen mbledhjet plenare ose të komisioneve apo të lëvizin lirshëm në ndërtesë, siç ndodh aktualisht. Megjithatë, gazetarët e

92 Media Freedom Rapid Response Report Albania, 2022. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3N22JUJ>

93 International Press Institute, 2021, MFRR urges government to scrap new media and information agency. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3NXSL8y>

94 Bino, B. (2021). "Media Freedom in Albania: Such a Frail Thing" p. 9-15. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/39BaxQ3>

95 Dokument politikash i IDM, për më shumë vizitoni. Aksesuar më 3.5.2022. <https://bit.ly/3HAKJAK>

96 Newsroom. "Ministria e Propagandës' Shqiptare: Ku jemi sot?". <https://bit.ly/3O3vAd6>

97 Hoxhaj, Edmond. (2021). "KLGJ vijon praktikën e mbledhjeve plenare të mbyllura"; Reporter.al. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3O3vInk>

transmetuesit publik RTSH dhe të agjencisë publike të lajmeve ATSH do të vazhdojnë të kenë akses. Aksesit në transmetimet video gjatë takimeve do t'u sigurohet mediave nga vetë Kuvendi. Këto masa do të kufizojnë aksesin e gazetarëve të ligjvënës, duke kufizuar kështu mundësitë për të bërë pyetje kritike dhe për t'u angazhuar në debate. Gjithashtu, janë ngritur shqetësime se kontrolli nga personeli i Kuvendit për burimet e videoeve mund të shkaktojë censurë ose manipulime. Për më tepër, dallimi mes gazetarëve që punojnë për mediat private dhe atyre që punojnë për transmetuesin publik do të krijojë një sistem të njëanshëm aksesit që është arbitrar dhe i padrejtë.

Sa të hapur me publikun janë qeveria dhe ministrinë e saj?

Në përgjithësi, gazetarët e konsiderojnë Qeverinë dhe ministrinë e saj si jo shumë të hapura dhe transparente. Në shtator 2021, qeveria shqiptare njoftoi ngritjen e një Agjencie të re për Mediat dhe Informim (AMI) që do të centralizonte në një agjenci të vetme marrëdhëniet e institucioneve të qeverisë me publikun dhe informimin e publikut. Kjo agjenci funksionon si ent publik juridik, në varësi të Kryeministrit, dhe drejtohet nga Endri Fuga, Drejtori i tij i Komunikimit dhe financohet nga "buxheti i shtetit, donacionet dhe burimet e tjera të ligjshme".⁹⁸ Sipas qeverisë, misioni i kësaj agjencie është të sigurojë transparencë në lidhje me politikën, aktivitetet, projektet, ngjarjet dhe çështjet e tjera përfshirë aktet e Këshillit të Ministrave dhe institucioneve të tjera shtetërore.⁹⁹

Përgjegjësia e saj e vetme është të informojë dhe të komunikojë me publikun dhe mediat dhe të përgatisë qëndrimet e qeverisë për çështje me interes publik. Po ashtu, kjo agjenci do të përgatisë deklarata shtypi dhe materiale për mediat për të plotësuar sasinë e filmimeve të redaktuara nga kanali personal televiziv i Ramës, filmime dhe materiale që i dërgohen të gjitha redaksive. AMI monitoron edhe mediat dhe "mjetet e komunikimit masiv" për të vlerësuar opinionet e tyre për qeverinë.¹⁰⁰ Sipas një vlerësimi të Institutit Ndërkombëtar të Shtypit (IPI), të gjitha përgjigjet bashkërendohen në qendër dhe materialet për shtypin krijohen dhe dërgohen vetëm nga një zyrë. Komunikimi me median apo publikun mund të bëhet vetëm me lejet e posaçme dhënë nga Fuga, i cili ka autoritetin për të marrë e pushuar nga puna zëdhënësit e shtypit.¹⁰¹ Megjithatë, qeveria shqiptare ka ngulur këmbë se qëllimi i agjencisë është të rrisë transparencën dhe përmirësojë komunikimin me mediat.

⁹⁸ Gjoka, Blerina (2022). "Kryeministri Rama cakton zëdhënësin e tij të drejtë agjencinë e informimit", *Balkan Insight*. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3HzJYHv>

⁹⁹ *Safe Journalists Network*. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3xEfL5W>

¹⁰⁰ *Instituti Ndërkombëtar i Shtypit*, (2022). "Ministria e Propagandës në Shqipëri: Ku jemi kështu?". Aksesuar më 13.5.2022. <https://ipi.media/albanian-ministry-of-propaganda-where-we-are-today/>

¹⁰¹ *Instituti Ndërkombëtar i Shtypit*, (2022). "Ministria e Propagandës në Shqipëri: Ku jemi kështu?". Aksesuar më 13.5.2022. <https://ipi.media/albanian-ministry-of-propaganda-where-we-are-today/> (Aksesuar më 13.05.2022).

B

Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve

B1 Kufizimet ekonomike për lirinë e gazetarëve

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune? A u paguhen të plota sigurimet shoqërore e shëndetësore? Sa të mira janë pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

Nuk ka pasur përmirësime për të drejtat e punës së gazetarëve në Shqipëri për vitin 2021. Plot 5970 gazetarë kanë kontratë pune dhe 1760 punojnë pa kontratë.¹⁰² Rreth 80 për qind e gazetarëve janë të moshës nën 35 vjeç dhe paguhen më pak se 300 dollarë në muaj, dhe pothuajse për 48 për qind të tyre pagat iu vonuan 2-6 muaj në 2021.¹⁰³ Siç është evidentuar edhe nga studimet e mëparshme,¹⁰⁴ mungesa e kontratave të punës mbetet problem, veçanërisht për gazetarët e rinj dhe ata që punojnë për mediat online. Pagesat e sigurimeve janë ende problem shqetësues, veçanërisht mungesa ose leja e kufizuar e lindjes për të dy prindërit. Rregullsia e pagesave të pagave është ende problem, veçanërisht për gazetat, mediat online dhe ato vendore.

¹⁰² Hoxhaj, Andi. (2022). *Nations in Transit 2022 Albania*. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3Or0YC9>

¹⁰³ *Ibid*

¹⁰⁴ *Tregu i punës në media në Shqipëri 2019*, IDRA. Aksesuar më 15.3.2021. <https://bit.ly/2GbCdtv>

Në ç'gjendje janë kushtet e punës së gazetarëve? Cilat janë problemet më të mëdha që hasin në vendin e punës?

Kushtet e punës së gazetarëve nuk janë përmirësuar as në 2021 dhe vihen re tendenca që lidhen me mosrespektimin e kushteve të punës, të tilla si mohimi i pushimeve të paguara, abuzimi verbal në vendin e punës dhe diskriminimi për shkak të gjinisë ose bindjeve politike; mungesa e sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës; problemet e sigurisë në lidhje me raportimin e krizave të tilla si tërmeti, COVID-19, përmblytjet, protestat, etj.¹⁰⁵ Gazetarët e mediave online raportohen më shpesh se punonjë në të zezë (pa kontrata pune) dhe në kushte anonimati. Kjo gjë nuk u bën të mundur atyre të mbrojnë të drejtat e autorit dhe as të krijojnë një profil personal profesional, për t'u bërë kështu pjesë e barabartë e komunitetit të gazetarëve profesionistë.¹⁰⁶ Shkelja e të drejtës së autorit është problem i madh edhe në mediat audiovizive, ato të shkruara dhe ato online.

B2 Pavarësia editoriale në mediat private

A kanë të miratuara mediat private rregulla organizative sipas të cilave redaksitë janë të ndara dhe të pavarura nga drejtuesit dhe drejtoria e marketingut?

Tendencat për sa i përket pavarësisë editoriale në mediat private nuk është përmirësuar as në vitin 2021. Pjesa më e madhe e tyre janë të vogla dhe me burime të kufizuara, ku i njëjti person mund të ushtrojë funksione të ndryshme. Prandaj, ndarja e redaksisë nga drejtuesit dhe marketingu nuk është gjithmonë e mundur.¹⁰⁷ Pak media të mëdha private kanë të miratuar, të paktën në letër, rregulla organizative për të siguruar pavarësinë editoriale duke i ndarë redaksitë nga drejtuesit dhe drejtoria e marketingut. Gjithsesi, pavarësia editoriale në praktikë komprometohet nga mediat e njëanshme, lidhjet e pronarëve të mediave me politikën, interesat e biznesit dhe madje edhe lidhjet me krimin e organizuar.¹⁰⁸

105 Valbona Sulçe Kolgeci dhe Endrit Shabani, "Raport Studimor mbi të Drejtat e Punës së Gazetarëve", 2020. Aksesuar më 15.3.2021. <https://bit.ly/3xDzfaP>

106 Intervistë me profesionist të medias, janar 2021. Konfirmuar nga <https://bit.ly/3tHGygm>

107 Fokus grup me mediat lokale, mars 2021.

108 Reporterët pa Kufi, 2022, Raporti për Shqipërinë. Aksesuar më 13.5.2022. <https://rsf.org/en/country/albania>

A kanë miratuar mediat rregulla të tjera për të ruajtur pavarësinë editoriale nga pronarët dhe organet drejtuese? A respektohen këto rregulla?

Pavarësia editoriale si një tregues i qartë i integritetit të medias dhe kusht themelor për besimin te media dhe përmbajtja cilësore është jashtëzakonisht e pasigurt në Shqipëri. Për më tepër, mediat private në Shqipëri më me ndikim zotërohen nga një pjesë e vogël kompanish, të cilat kanë lidhje me politikanë dhe në të njëjtën kohë operojnë në sektorë shumë të rregulluar, të tilla si ndërtimi.¹⁰⁹ Nuk ka transparencë në lidhje me pronësinë e mediave dhe pavarësinë editoriale në pjesën më të madhe të mediave private.

A kanë redaksitë e lajmeve të mediave private kode të brendshme etike apo respektojnë një kod të përgjithshëm etike?

Situata është e njëjtë si në vitin 2020. Në përgjithësi, mediat private nuk kanë politikë të shkruar për standardet e etikës apo kode të miratuara etike, por ato respektojnë standardet e përcaktuara nga Këshilli i Shqiptar i Medias¹¹⁰ apo shoqata të tjera gazetarësh në vend.¹¹¹

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron mbi redaksitë apo mbi gazetarë të caktuar?

Format më të zakonshme të presionit që pronarët dhe drejtuesit e mediave ushtrojnë mbi redaksitë apo mbi gazetarë të caktuar janë mbyllja e emisioneve ose anulimi i raportimeve ose formateve të tjera të lajmeve/përmbajtjes, kërcënimi, pasiguria ekonomike, ngacmimi, kontrolli mbi përmbajtjen dhe mashtrimi, madje edhe shantazi.

Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar nga pronarët apo drejtuesit e mediave mbi një redaksi të tërë ose gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar?

Nuk ka asnjë informacion publik për presionin e ushtruar nga pronarët apo drejtuesit e mediave mbi një redaksi të tërë apo mbi gazetarë të caktuar në vitin 2021. Megjithatë, presionet ushtrohen edhe pse gazetarët nuk i raportojnë ato, po të kemi parasysh se harta e pei-

109 Ibid

110 Instituti Shqiptar i Medias, "Kodi i Etikës për Gazetarët në Shqipëri". Aksesuar më 13.5.2022. <https://ksshm.al/en/code-of-ethics-for-journalists/>

111 Fokus grup me mediat lokale, dhjetor 2020.

zazhit mediatik vazhdon të tregojë më tej përqendrimin e tregut dhe audiencës në duart e pak pronarëve, të cilët i përdorin kanalet e tyre mediatike për interesat e tyre ekonomike dhe për axhendat politike.¹¹²

B3 Pavarësia editoriale e transmetuesit të shërbimit publik

A ka të miratuar një kode sjelljeje për gazetarët dhe pavarësi editoriale transmetuesi i shërbimit publik? A e respektojnë gazetarët këtë kod?

Transmetuesi i Shërbimit Publik (TSHP) është i detyruar me ligj të ketë një kod sjelljeje dhe kod etike të miratuar si dhe të sigurojë pavarësinë editoriale. Gazetarët trajnohen për pavarësinë editoriale nga TSHP si dhe nga donatorët. Që nga viti 2020, ky transmetues publikoi online kodin e etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale ku përshkruhej parimi kryesor i pavarësisë së tij editoriale përfshirë këtu edhe kodin e etikës dhe standardet profesionale.¹¹³ Në praktikë, me gjithë përparimin e shndërrimit të RTSh-së në një media në shërbim të publikut, ajo ende perceptohet se favorizon partinë në pushtet në raportimin e saj mediatik.¹¹⁴

A kanë organet e TSHP rregulla të brendshme organizative për ta siguruar pavarësinë e redaksisë nga organet drejtuese të TSHP-së? A respektohen këto rregulla?

Në parim, redaksia e TSHP është e ndarë nga organet drejtuese. Sipas Ligjit për Mediat Audiovizive të vitit 2013, tre organet drejtuese të RTSh janë: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, dhe Bordi i Administrimit (Ligji Nr. 97/2013). Këshilli Drejtues është organi më i lartë drejtues, Drejtori i Përgjithshëm mbikëqyr menaxhimin e përditshëm dhe Bordi i Administrimit është bord këshillimor i Drejtorit të Përgjithshëm për çështje financiare dhe administrative, por që nuk lidhen me programin dhe përmbajtjen. Këto struktura supozohet të sigurojnë pavarësinë e redaksisë së bashku me politikën editoriale, kodin e etikës dhe standardet profesionale. Në praktikë, drejtuesit kanë tendencë të ndikojnë në punën e redaksisë dhe të gazetarëve.

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria ushtron mbi redaksitë apo mbi gazetarët e Transmetuesit të Shërbimit Publik?

Forma më e zakonshme e presionit është e tërthortë dhe lidhet me qasjen që RTSh favorizon partinë në pushtet për sa i përket mbulimit që i bëhet duke qenë se Këshilli Drejtues zgjidhet me votat e shumicës në Kuvend.

Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar nga qeveria mbi të gjithë redaksinë ose te gazetarë të caktuar gjatë vitit të kaluar?

Shqetësimet kryesore nuk kanë të bëjnë me presionin e drejtpërdrejtë nga qeveria, por më shumë nga marrëdhëniet delikate dhe simbiotike mes pronarëve, politikanëve dhe interesave të tjera të fuqishme. Nga ana tjetër, duke e bërë gazetarinë profesionale të duket si e dalë mode dhe duke denigruar median përmes fushatave shpifëse dhe debatit kundër mediave, qeveria ushtron presion të tërthortë ndaj gazetarëve. Forma të tjera janë paditë për shpifje dhe kërcënimet me padi ligjore kundër gazetarëve investigativë si dhe shkelja e të dhënave dhe sigurisë dixhitale.

B4 Pavarësia editoriale në mediat jofitimprurëse

A kanë të miratuar mediat jofitimprurëse një kod sjelljeje dhe të pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respektojnë gazetarët këtë kod?

Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jofitimprurëse është në nivel më të lartë. Këto mediat kanë të miratuar kodin e sjelljes së gazetarëve dhe gazetarët respektojnë pavarësinë editoriale. Këtu bëjnë pjesë media investigative, media fakt-verifikuese dhe zakonisht media të orientuara drejt misionit që i shërbejnë komunitetit dhe kështu përpiqen të respektojnë pavarësinë editoriale. Këto media priren të përdorin Kodin e Etikës të botuar nga Instituti Shqiptar i Medias dhe të rishikuar në vitin 2018 dhe Këshilli Shqiptar i Medias ishte pjesë e grupit të punës dhe respekton po këtë kod.¹¹⁵

112 Haxhaj, Andi. (2022). Nations in Transit 2022 Albania. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3UlnHrx>

113 Kodi i etikës, parimet editoriale dhe standardet profesionale të RTSH gjenden në adresën: <https://bit.ly/3QuqnmN>

114 Diskutim në fokus grupe me gazetarë, dhjetor 2020.

115 Kodi i Etikës. <https://kshml.al/wp-content/uploads/2018/04/Kodi-i-Etikës-final-shqip-3.pdf>

Cilat janë format më të zakonshme të presionit mbi mediat jofitimprurëse?

Mediat jofitimprurëse në Shqipëri janë më të pakta në numër dhe më të vogla për sa i përket madhësisë në krahasim me mediat fitimprurëse private. Ato përballen me vështirësi që lidhen me lirinë e medias, qëndrueshmërinë financiare dhe sigurinë ashtu si edhe mediat e tjera. Për shembull, format më të zakonshme të presionit ndaj mediave jofitimprurëse janë mungesa e fondeve për prodhimin dhe zgjerimin e përmbajtjes; Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (që njihen me termin "Paditë SLAPP") me anë të të cilave bëhen përpjekje për të frikësuar dhe dekurajuar raportimin investigativ; dhe mungesa e aksesit tek informacioni publik që ka të bëjë me transparencën e kufizuar të institucioneve publike dhe me frikësimin e gazetarëve.

Cili ishte shembulli më tipik i presionit të ushtruar mbi mediat jofitimprurëse?

Për vitin 2021, nuk ka shembuj të mirëfilltë të presionit të ushtruar ndaj mediave jofitimprurëse. Shembulli më i njohur mbetet padia SLAPP kundër gazetarëve të BIRN në dhjetor 2020 dhe kundër reporterit lokal Artan Rama, shembuj që janë dhënë në raportin e vitit të kaluar.

B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

Sa liri kanë gazetarët në përzgjedhjen e lajmeve për të cilat punojnë dhe për të vendosur se cilin aspekt të lajmit duhet të nxjerrin në pah?

Në përgjithësi, gazetarët janë të lirë të zgjedhin lajmet që duan të transmetojnë për aq kohë sa ato nuk bien ndesh me interesat e pronarit të medias apo interesat politike dhe me trafikimin e influencave të tjera. Politika editoriale e organeve mediatike, pozicioni i redaksisë përkundër atij të pronarëve dhe drejtuesve, si dhe për strukturën e pronësisë së medias dhe të ardhurat janë faktorë të tjerë që ndikojnë në lirinë e gazetarëve për të përzgjedhur lajmet ose kronikat e tyre. Në vitin 2021, autocensura ishte ende e pranishme në të gjithë botën. Siç u raportua edhe në vitin 2020, në disa raste, redaktimi i përmbajtjes së lajmeve ose heqja e disa prej pjesëve të lajmit është praktikë më se e zakonshme në redaksi.

Sa shpesh marrin pjesë në takime koordinuese editoriale të redaksive (pjesëmarrjen në takimet e redaksisë apo caktimi i reporterëve)?

E njëjta tendencë vihet re edhe për vitin 2021 ku gazetarët marrin pjesë çdo ditë në të paktën një takim koordinues të redaksisë, në të cilën përcaktohen historitë/temat që do të trajtohen. Kjo është procedura për pjesën më të madhe të mediave, por për ato të vogla e private, gazetarët nuk takohen domosdoshmërisht në një mjedis kaq të zyrtarizuar, por organizohen takime informale të atypëratyshme për të përcaktuar temat që do të trajtohen. Për shumicën e portaleve të mediave online, të cilat funksionojnë në anonimitet, situata është e ndryshme me përmbajtje shumë të pakët origjinale dhe pak lajme të prodhuara nga vetë ata, ku stafi i tyre punon kryesisht me copy/paste lajmesh ose përkthim nga portale apo media të tjera të huaja. Kjo është një tjetër shenjë e përkeqësimit të cilësisë dhe raportimit të medias dhe shkelje e qartë e të drejtave të autorit.

Cili është qëndrimi i gazetarëve në lidhje me etikën e gazetarëve?

Gazetarët deklarojnë se në përgjithësi e respektojnë Kodin e Etikës dhe janë në favor të forcimit të zbatimit të tij. Gjithsesi, jo të gjithë gazetarët kanë kapacitetet dhe ndërgjegjësimin për të respektuar këtë kod dhe shumica e tyre nuk trajnohet rregullisht në këtë drejtim. Pavarësisht qëndrimeve të tilla, në praktikë në disa raste vetë gazetarët bëjnë raportime pa etikë, veçanërisht kur raportojnë për raste të veçanta sociale që kanë dhunë, dramë dhe konflikte.

Cilat janë vetë-perceptimet e gazetarëve për nivelin e ndikimit tek ta të rreziqeve dhe të burimeve të ndryshme të ndikimit?

Sipas vlerësimit tonë, gazetarët janë të ndërgjegjësuar për nivelin e ndikimit tek ta të rreziqeve dhe burimeve të ndikimit, veçanërisht siguria, presionet nga qeveria dhe forma tjetër e kërcënimit nga pronarët. Kjo çon në vetëcensurë si praktikë normale.

Sa gazetarë raportojnë censurë nga redaktorët? Sa gazetarë raportojnë se iu nënshtruan vetëcensurës për shkak të kërcënimit apo humbjes së vendit të punës ose për shkak të rreziqeve të tjera?

Në vitin 2021, vihet re censurë dhe vetëcensurë në redaksitë e mediave në Shqipëri ashtu si edhe vitin e kaluar. Disa studime konfirmojnë se ato vijnë nga presionet politike dhe ekonomike, mungesa e qën-

drueshmërisë financiare të mediave, mungesa e profesionalizmit dhe mungesa e etikës dhe e respektimit të të drejtave të gazetarëve. Në Shqipëri censura dhe vetëcensura janë më të zakonshme në mediat audiovizive dhe në shtyp që kontrollohen nga një pjesë e vogël e familjeve të fuqishme, të cilat kanë lidhje biznesesh në tregjet e rregulluara.¹¹⁶ Mediat online janë më të larmishme. Ato janë në hapat e parë dhe në disa raste drejtohen nga gazetarë profesionistë, të cilët u japin më shumë liri gazetarëve për të raportuar histori nga këndvështrime të ndryshme.

B6 Pozicioni ekonomik i grave gazetare

A punojnë gazetare femra në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre meshkuj? A kanë nënshkruar kontrata pune po aq shpesh sa edhe burrat?

Në përgjithësi, gratë gazetare raportojnë në kushte më të këqija pune se kolegët e tyre meshkuj. Në vitin 2021, gratë e gazetarisë raportojnë raste të ngacmimeve seksuale dhe dhune online apo disinformim për shkak të gjinisë. Gjithsesi, nuk ka pasur raportime tek autoritetet për raste të tilla dhe gratë gazetare hezitojnë të dalin publikisht për të tilla raste.

A priren gratë të mbajnë pozicione drejtuese editoriale në redaksi po aq sa edhe burrat?

Edhe pse gratë përfaqësojnë numrin më të madh të gazetarëve në Shqipëri, ka pak prej tyre që kanë poste drejtuese në redaksi. Mungesa e të dhënave sipas gjinisë është problem i vazhdueshëm.

Sa të larta janë pagat e tyre në krahasim me ato të meshkujve?

Nuk ka të dhëna të besueshme të ndara sipas gjinisë për pagat e gazetarëve femra dhe meshkuj. Përgjithësisht, mendohet se gratë paguhen më pak.

A bëhen ato subjekt i presioneve të caktuara për shkak të gjinisë?

Ashtu si edhe në raportimin e kaluar, gratë gazetare raportojnë ngacmim seksual, dhunë online dhe fushata shpifjesh si presione me bazë gjinore. Megjithatë, raste të tilla nuk denoncohen zyrtarisht dhe zakonisht nuk ngrihen akuza për shkak të një klime ku mbizotëron kërcërimi dhe një qëndrim i përgjithshëm të 'fajësimit të viktimës'. Toleranca ndaj shkeljeve është e përhapur si tek punëdhënësit ashtu edhe te gazetarët, të cilët zakonisht e konsiderojnë veten si të pafuqishëm për të ndryshuar realitetin.

¹¹⁶ Safija Todorovic, "Oeverisje me Internet, çelësi i lirisë së medias në Shqipëri", *Balkan Insight*, 10.9.2020. Aktesuar më 15.3.2021. <https://balkaninsight.com/2020/09/10/internet-governance-key-to-media-freedom-in-albania/>



C1 Statistikat për sigurinë dhe pandëshkueshmërinë

Rrjeti “Gazetarët e sigurt” ka regjistruar dhe raportuar 14 raste sulmesh kundër gazetarëve.¹

Numri i kërcënimeve dhe ngacmimeve jo-fizike

Andi Bushati dhe Armand Shkullaku, pronarë dhe redaktorë të portalit lapsi.al u thirrën për t’u pyetur nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) si pjesë e një hetimi të hapur zyrtarisht për rrjedhjen e të dhënave personale të 910,000 mijë qytetarëve (që dyshohej si baza e të dhënave e Partisë Socialiste në pushtet dhe që përdorej për qëllime elektorale).

Numri i kërcënimeve kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve

Më 21 gusht, gazetarja e Exit Alice Taylor mori kërcënime në Facebook ku jepeshin hollësi se si mund ta gjenin dhe se do t’i rripnin skalpin e kokës. Ajo bëri denoncim në rajonin e policisë të lagjes ‘Ali Demi’. Aty i thanë që emri që ishte përdorur nga përdoruesi ishte nga një profil fals dhe se çështja do t’i dërgohej për hetim të mëtejshëm drejtorisë së krimit kibernetik.

Tabela2: Numri i sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve në vitin 2021

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<p>Kërcënime dhe ngacmime jo-fizike</p> <ul style="list-style-type: none"> Në kërcënimet dhe ngacmimet jo-fizike bëjnë pjesë: Mbikëqyrje ose ndjekje; Ngacim me thirrje telefonike; Ngacim arbitrar gjyqësor ose administrativ; Deklarata agresive nga zyrtarë publikë; Forma të tjera presioni që mund të vënë në rrezik sigurinë e gazetarëve në vijimin e punës. <p>Këto lloj kërcënimesh nuk përfshijnë rrethimin apo bulizmin në mjedisin e punës.</p>	2 (M)	<ul style="list-style-type: none"> Andi Bushati dhe Armand Shkullaku, pronarë dhe redaktorë të portalit lapsi.al u thirrën për t'u pyetur nga Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) si pjesë e një hetimi të hapur zyrtarisht për rrjedhjen e të dhënave personale të 910,000 mijë qytetarëve (që dyshohej si baza e të dhënave e Partisë Socialiste në pushtet dhe që përdorej për qëllime elektorale).
<p>Kërcënimet kundër jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve</p> <p>Këtu përshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> Kërkesa për vrasjen e gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; Kërkesa për dëmtime fizike kundër gazetarëve, miqve, familjes ose burimeve të gazetarëve; <p>Këto kërcënime mund të:</p> <ul style="list-style-type: none"> Bëhen drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet palëve të treta; Dërgohen me komunikim elektronik ose ballë për ballë; Jenë të drejtpërdrejta ose të nënkuptuara. 	1 (F)	<ul style="list-style-type: none"> Më 21 gusht, gazetarja eExit Alice Taylor mori kërcënime në Facebook ku jepeshin hollësi se si mund ta gjenin dhe se do t'i rripnin skalpin e kokës. Ajo bëri denoncim në rajonin e policisë të lagjes 'Ali Demi'. Aty i thanë që emri që ishte përdorur nga përdoruesi ishte nga një profil fals dhe se çështja do t'i dërgohej për hetim të mëtejshëm drejtorisë së krimin kibernetik.
<p>Sulme faktike ndaj gazetarëve</p> <p>Llojet e sulmeve faktike mund të jenë dëmtimet fizike ose mendore, rrëmbimet, dhunimi i shtëpisë/zyrave, sekuestrimi i pajisjeve, ndalimi arbitrar, tentativa të dështuara për vrasje, etj.</p>	9 (5 M 4 F)	<ul style="list-style-type: none"> Gazetari televiziv i Fax News Besarta Demushaj, të mërkurën (15.12.2021) denoncoi sulmin fizik dhe verbal të ushtruar ndaj tij nga dy persona gjatë raportimit (14.12.2021). Pamjet me video tregojnë gazetarin duke u penguar, u shkelmuar dhe goditur nga dy burra teksa raportonte për një ngjarje. Fax News ishte në Vorë ku banorët po protestonin për një segment rrugor në gjendje të mjerueshme. Mirëpo, përfaqësues të bashkisë nuk i lejuan banorët të bënin protestën e tyre dhe penguan grupin e xhirimit të Fax News të përcillte protestën pasi, sipas tyre, kjo çështje nuk duhej të dilte në media. Në muajin shkurt, Fjona Çela, gazetare e Fax News, u pengua nga zëdhënësja për media e Ministrisë së Shëndetësisë Etiola Kola të intervistonte stafin mjekësor në institucionet publike. Çela tha se ajo ishte refuzuar ose injoruar vazhdimisht kur bënte kërkesa zyrtare në Ministri. Një punonjës policie tentoi t'i shtynte në buzë të humnerës dy gazetarë, akt që mund t'u rrezikonte edhe jetën atyre duke pasur parasysh terrenin e vështirë. Ngjarja u raportua menjëherë tek autoritetet. Më vonë po atë ditë, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të Ministrisë së Brendshme konfirmoi se kishte nisur hetimet në lidhje me dhunën e ushtruar nga një punonjës policie ndaj gazetares së Top Channel (Anila Hoxha) dhe Endri Agas të ekipit të televizionit A2CNN gjatë raportimit për një vrasje në zonën e Qafë Mollës. Reporter i Fax News, Ledio Guni, u sulmua fizikisht në Tiranë më 11 tetor, teksa raportonte për një grindje mes mësuesve dhe familjeve të nxënësve në lokalin pranë gjimnazit "Çajupi". Ai ishte në detyrë duke raportuar drejtpërsëdrejti nga vendi i ngjarjes, por teksa filmonte me aparatën e tij nga makina e medias që ai përfaqësonte, një burrë e sulmoi fizikisht duke e gjuajtur me karrige. Punonjës të Policisë së Shtetit ndaluan më 27 korrik në orën 12:30 gazetarin e televizionit "News 24" në Tiranë, Ergjys Gjencajn dhe shtynë kolegen e tij Klodiana Lala, pasi nuk arritën dot të ndalonin një të dyshuar për vrasje. Takimi elektorale i kryebashkiakut të Tiranës Erion Veliaj në Kavajë u kthye në incident ndaj grupit të xhirimit të televizionit Ora News dhe gazetarit Ronaldo Sharka. Në një intervistë në studion e Ora News, gazetari Ronaldo Sharka tha: "Isha me mikrofon, me logon e medias, lehtësisht të identifikueshme dhe iu drejtova zotit Veliaj, për pyetje në interes të opinionit publik, por situata ishte shumë serioze dhe aty kuptova se diçka nuk shkonte." Më 12 prill 2021, gazetari i Ora News, Isa Myzyraj, u ndalua fizikisht dhe u pengua nga një roje sigurie i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, kur gazetari u përpoq të bënte pyetje teksa politíkani doli nga një kafene pas një ngjarjeje. Në një video të publikuar nga Ora News, shihet se si gazetari i afrohet kryebashkiakut me mikrofon në dorë për ta intervistuar, kur ai tërhiqet menjëherë mënjani nga një prej rojeve të sigurisë. Roja e tërhoqi zvarrë gazetarin në një rrugicë dhe e mbajti të mbërthyer derisa kryetari i bashkisë hipi në një makinë që e priste në rrugë dhe u largua. Gjatë ngjarjes, Myzyraj u identifikua vazhdimisht si gazetar.

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
Vrasja e gazetarëve (në 15-20 vitet e fundit) Llojet e vrasjeve mund të jenë shkëmbim zjarri, vrasje me paramendim, shpërthim bombe, rrahje për vdekje, etj.	0	
Kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve Sulme faktike ndaj pronave të organeve dhe organizatave të mediave, personelit të tyre, sekuestrim pajisjes, deklarata agresive nga zyrtarë publikë, etj. Po ashtu, në kërcënime dhe sulme të tilla mund të jenë edhe ato të kategorive të mësipërme.	2	Kryeministri Edi Rama bëri thirrje për rregullime në lirinë e shprehjes në mediat online gjatë fjalimit të tij në Forumin Mediatik të OSBE-së për Evropën Juglindore të mbajtur në Tiranë. Gjatë ndërhyrjes së tij, Rama i krahasoi kërcënimet për disinformim dhe shpifje në mediat online me propagandën naziste dhe pohoi se politikanët nuk kanë mundësi të mbrohen kundër tyre pasi “ju etiketoheni menjëherë se jeni kundër lirisë bla bla bla”. Gjatë një konference për shtyp në shtator mes kryeministrit Edi Rama dhe kancelares së atëhershme gjermane Angela Merkel, Rama refuzoi t’u përgjigjej pyetjeve nga gazetarët kosovarë (Enis Reçica i TV Klan Kosova).

Numri i sulmeve faktike ndaj gazetarëve

Gazetari televiziv i Fax News Besarta Demushaj, të mërkurën (15.12.2021) denoncoi sulmin fizik dhe verbal të ushtruar ndaj tij nga dy persona gjatë raportimit (14.12.2021). Pamjet me video tregojnë gazetarin duke u penguar, u shkëmbuar dhe goditur nga dy burra teksa raportonte për një ngjarje.

Fax News ishte në Vorë ku banorët po protestonin për një segment rrugor në gjendje të mjerueshme. Mirëpo, përfaqësues të bashkisë nuk i lejuan banorët të bënin protestën e tyre dhe penguan grupin e xhirimit të Fax News të përcillte protestën pasi, sipas tyre, kjo çështje nuk duhej të dilte në media.

Në muajin shkurt, Fjona Çela, gazetare e Fax News, u pengua nga zëdhënësja për media e Ministrisë së Shëndetësisë Etiola Kola të intervistonte stafin mjekësor në institucionet publike. Çela tha se ajo ishte refuzuar ose injoruar vazhdimisht kur bënte kërkesa zyrtare në Ministri.

Një punonjës policie tentoi t’i shtynte në buzë të humnerësdy gazetarë, akt që mund t’u rrezikonte edhe jetën atyre duke pasur parasysh terrenin e vështirë. Ngjarja u raportua menjëherë tek autoritetet. Më vonë po atë ditë, Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave të Ministrisë së Brendshme konfirmoi se kishte nisur hetimet në lidhje me dhunën e ushtruar nga një punonjës policie ndaj gazetares së Top Channel (Anila Hoxha) dhe Endri Agas të ekipit të televizionit A2CNN gjatë raportimit për një vrasje në zonën e Qafë Mollës.

Reporterit i Fax News, Ledio Guni, u sulmua fizikisht në Tiranë më 11 tetor, teksa raportonte për një grindje mes

mësuesve dhe familjeve të nxënësve në lokalin pranë gjimnazit “Çajupi”. Ai ishte në detyrë duke raportuar drejtpërsëdrejti nga vendi i ngjarjes, por teksa filmonte me aparatit e tij nga makina e medias që ai përfaqësonte, një burrë e sulmoi fizikisht duke e gjuajtur me karrige.

Punonjës të Policisë së Shtetit ndaluan më 27 korrik në orën 12:30 gazetarin e televizionit “News 24” në Tiranë, Ergjys Gjencajn dhe shtynë kolegen e tij Klodiana Lala, pasi nuk arritën dot të ndalonin një të dyshuar për vrasje.

Takimi elektoral i kryebashkiakut të Tiranës Erion Veliaj në Kavajë u kthye në incident ndaj grupit të xhirimit të televizionit Ora News dhe gazetarit Ronaldo Sharka. Në një intervistë në studion e Ora News, gazetari Ronaldo Sharka tha: “Isha me mikrofon, me logon e medias, lehtësisht të identifikueshme dhe iu drejtova zotit Veliaj, për pyetje në interes të opinionit publik, por situata ishte shumë serioze dhe aty kuptova se diçka nuk shkonte.”

Më 12 prill 2021, gazetari i Ora News, Isa Myzyraj, u ndalua fizikisht dhe u pengua nga një roje sigurie i kryetarit të Bashkisë së Tiranës, kur gazetari u përpoq të bënte pyetje teksa politikani doli nga një kafene pas një ngjarjeje. Në një video të publikuar nga Ora News, shihet se si gazetari i afrohet kryebashkiakut me mikrofon në dorë për ta intervistuar, kur ai tërhiqet menjëherë mënjani nga një prej rojeve të sigurisë. Roja e tërhoqi zvarrë gazetarin në një rrugicë dhe e mbajti të mbërthyer derisa kryetari i bashkisë hipi në një makinë që e priste në rrugë dhe u largua. Gjatë ngjarjes, Myzyraj u identifikua vazhdimisht si gazetar.

Numri dhe llojet e vrasjes së gazetarëve

Nuk ka.

Numri dhe llojet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj institucioneve, organizatave të medias dhe shoqatave të mediave dhe gazetarëve

Kryeministri Edi Rama bëri thirrje për rregullime në lirinë e shprehjes në mediat online gjatë fjalimit të tij në Forumin Mediatic të OSBE-së për Evropën Juglindore të mbajtur në Tiranë. Gjatë ndërhyrjes së tij, Rama i krahasoi kërcënimet për disinformim dhe shpifje në mediat online me propagandën naziste dhe pohoi se politikanët nuk kanë mundësi të mbrohen kundër tyre pasi "ju etiketoheni menjëherë se jeni kundër lirisë bla bla bla".

Gjatë një konference për shtyp në shtator mes kryeministrit Edi Rama dhe kancelares së atëhershme gjermane Angela Merkel, Rama refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve nga gazetarët kosovarë (Enis Reçica i TV Klan Kosova).

C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve

A ka dispozita të veçanta në ligje ose mekanizma të tjerë që synojnë të mbështesin sigurinë e gazetarëve, në terren dhe online?

Në Shqipëri siguria e gazetarëve si online ashtu edhe offline është përgjithësisht e garantuar, duke pasur parasysh lirinë e shprehjes, por nuk ka ligje të veçanta për sigurinë e tyre. Në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, shtetet anëtare (përfshirë Shqipërinë) kanë detyrime negative dhe pozitive për të mbrojtur gazetarët. Jo vetëm që ata duhet të mos bëjnë deklaratatë kërcënuese politike apo të nisnin procese gjyqësore kundër aktorëve të medias, por kanë për detyrë edhe t'u japin gazetarëve vazhdimisht mbrojtjen e plotë ligjore dhe gjyqësore në mënyrë që t'u krijojnë një mjedis të përshtatshëm për punën e tyre në gazetari.¹¹⁷ Siç u raportua edhe vitin e kaluar, në vitin 2021 vihet re se institucioneve shtetërore u mungo-

jnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe në terren.

A ka dokumente (protokolle, rregulla të procedurave, etj.) të miratuara nga institucionet shtetërore që u japin udhëzime shtesë forcave të armatosura dhe policisë për mënyrën se si të sillen me gazetarët?

Pavarësisht trajnimit dhe ndërgjegjësimit të autoriteteve publike si, p.sh., policia, për mënyrën se si të sillen me gazetarët dhe profesionistët e medias, protokollet zyrtare të miratuara në sistem dhe të institucionalizuar janë në numër të kufizuar.

A ka ndonjë mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe dhunën ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna për sulmet ndaj gazetarëve dhe për pandëshkueshmërinë?

Institucionet në Shqipëri nuk regjistrojnë dhe as publikojnë të dhëna në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve dhe pandëshkueshmërinë e tyre. Në të shumtën e rasteve, institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbledhur dhe publikuar të dhëna të tilla. Këshilli i Evropës, Përgjigja e Shpejtë për Lirinë e Mediave dhe Rrjeti i Gazetarëve të Sigurt janë mekanizmat kryesorë për monitorimin dhe raportimin e rregullt për kërcënime të tilla. Autoritetet shtetërore i përgjigjen njoftimeve nga Këshilli i Evropës.

A njihen sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve nga institucionet shtetërore si shkelje e lirisë së shprehjes dhe e Kodit Penal? A japin zyrtarët qeveritarë deklaratatë të qarta ku dënojnë sulmet ndaj gazetarëve?

Në vitin 2021, vihet re përgjithësisht se sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve zakonisht dënohen nga zyrtarët shtetërorë dhe konsiderohen si shkelje e lirisë së shprehjes. Policia ka reaguar publikisht shumë më shpejt në 2021. Megjithatë, hetimet e mëtejshme janë në një numër të kufizuar.

A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e sigurisë së gazetarëve?

Në vitin 2021, institucionet e pavarura, të tillë si Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Komisioneri i të Drejtës së Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, bashkëpunojnë me organizatat e gaze-

¹¹⁷ Këshilli i Evropës. "Kurse online për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve ofrohen në disa gjuhë të Ballkanit Perëndimor", gjendet në adresën. <https://bit.ly/3n0lr52>

tarëve dhe mediave për sigurinë e gazetarëve. Edhe Prokuroria e Përgjithshme dhe policia kanë bashkëpunuar me organizatat e gazetarëve për çështje të sigurisë së këtyre të fundit.

Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili ishte rasti më i fundit i mbikëqyrjes elektronike ndaj gazetarët?

Nuk ka raste zyrtare apo publike për mbikëqyrjen elektronike të gazetarëve për vitin 2021.

C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve

A ka njësi të veçanta brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile kushtuar hetimeve dhe ndjekjeve penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?

Për qëllime të këtij raporti, nga intervistat arrihet në përfundimin se nuk ka njësi të veçanta brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile që të merren me hetimet dhe ndjekjen penale të kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve.

A ofrojnë Prokuroria e Përgjithshme dhe Ministria e Brendshme burimet e nevojshme për të bërë hetimet për kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve?

Për qëllime të këtij raporti, nga intervistat arrihet në përfundimin se nuk ka asnjë dispozitë të veçantë për të siguruar burime të tjera që do të mbulonin dhe trajtonin hetimet për kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve. Megjithatë, ka një rritje të ndjeshmërisë ndaj rasteve të tilla. Agjencitë e zbatimit të ligjit janë mesatarisht të pajisura me njohuritë dhe burimet e nevojshme për të hetuar sulmet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Gjithsesi, mungojnë protokollet e veçanta të hetimeve për të bërë të mundur zbulimin dhe ndjekjen efikase të agresionit dhe dhunës ndaj gazetarëve. Vështirësitë e përgjithshme që lidhen me reformën në drejtësi dhe procesin e vetëgjitur në vazhdim ndikojnë në kapacitetet

dhe burimet e prokurorive dhe gjykatave për trajtimin e çështjeve të gazetarëve.¹¹⁸

A bëhen me shpejtësi, paanshmëri dhe efikasitet hetime për krimet ndaj gazetarëve, përfshirë këtu kërcënimet dhe frikësimet ndaj tyre?

Raporte dhe të dhëna të ndryshme nga gazetarët evidentojnë faktin se bëhen një numër i kufizuar hetimesh të paanshme dhe efikase për krimet ndaj gazetarëve. Në bazë të informacioneve të marra nga Prokuroria e Përgjithshme për procesin e hetimeve për vitin 2021, nga 9 sulme faktike ndaj gazetarëve në 2021, janë vetëm tre raste të denoncuar në organet ligjzbatuese: Procedimi penal nr. 749 i vitit 2022, që ka të bëjë me ngjarjen e gazetares Anila Hoxha dhe Ergys Gjencaj, ende nën hetim. Për çështjen e gazetarëve Klodiana Lala dhe Ergys Gjencaj rezultoi se ka dy procedime: Kallëzimi Penal Nr.10273 i vitit 2021, për të cilin më datë 17.09.2021 u vendos pushimi i çështjes dhe Procedimi Penal nr. 6767 i vitit 2021, për veprën penale “Ushtrimi i veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Më datë 17.12.2021, u depozitua kërkesa për pushimin e çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

A u ofrohen gazetarëve masa mbrojtëse kur e kërkojnë ata në përgjigje të kërcënimeve të besueshme për sigurinë e tyre fizike?

Institucionet shtetërore në Shqipëri nuk i kanë ngritur ende mekanizmat efikasë që të jenë të krijuar posaçërisht për gazetarët dhe stafin e medias për t’u ofruar atyre masa mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar. Gazetarëve nuk u ofrohet asnjë shërbim i specializuar ligjor. Institucioneve shtetërore u mungojnë burimet dhe kapacitetet për të mbrojtur gazetarët në hapësirën online dhe në terren. Mekanizmat e mbrojtjes dhe sigurisë së viktimave të parashikuara në ligj nuk janë të përshtatur për gazetarët dhe viktimat mund të mos përfitojnë nga mbrojtja e mjaftueshme apo nga ndonjë alternativë tjetër për ndryshim vendbanimi si masë mbrojtëse.

Në vitin 2021 u botua një Udhëzues Praktik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gazetarëve në kuadër të Programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022” dhe Projektit “Instrumenti Horizontal i Lirisë së Shprehjes dhe Liria e Medias në Shqipëri (JUFREX 2).¹¹⁹ Në kuadër të

118 Safe Journalists Network, *Index of Journalists Safety, 2021*. <https://safejournalists.net/safejournalists-index-tirana/>

119 Matlija, Dorian. (2021). “Udhëzues praktik për mbrojtjen dhe sigurinë e gazetarëve”. Aksesuar më 13.5.2022. <https://bit.ly/3Op1Bfn>

Projektit “Forcimi i Standardeve të Integritetit të Medias në Shqipëri”, mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë, në vitin 2021 u ndërmor një nismë tjetër për një protokoll sigurie për gazetarët. Me mbështetjen e ekspertëve, ky grup joformal ka hartuar një Protokoll të Reagimit të Shpejtë për Gazetarët.¹²⁰

Në rast vendimi të formës së prerë, ndëshkohen vetëm shkelësit apo edhe nxitësit/porositësit?

Në përgjithësi, në vendimet e formës së prerë jepen sanksione që i vendosen vetëm shkelësve.

A organizojnë institucionet trajnime të përshtatshme për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe të gazetarëve? A i organizojnë institucionet këto trajnime në bashkëpunim me shoqatat e gazetarëve?

Me mbështetje të donatorëve të huaj, janë organizuar trajnime, por ka nevojë për ngritje kapacitetesh si dhe rritje të ndërgjegjësimit.

¹²⁰ Protokollin synon të ofrojë sugjerime për hapat praktik që mund të ndjekë ky rrjet informal i gazetarëve – Gjenerata e Re – në rastet kur ata apo gazetarë të tjerë ndeshen me kërcënime.

Përfundimet dhe rekomandimet

Përfundime

Edhe pse Kushtetuta e Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes, të medias dhe të informimit, dispozitat e saj nuk zbatohen plotësisht në praktikë ku në 2021 evidentohen në Shqipëri shenja të përkeqësimit të lirisë së shprehjes, të drejtës së informimit dhe lirisë të shtypit. Sfida kryesore strukturore e ekosistemit mediatik që ndikon negativisht në lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në Shqipëri është marrëdhënia e ndërthurur simbiotike mes interesave të fuqishme ekonomike dhe politike në sistemin mediatik, përfshirë këtu, në disa raste, ndikimin e krimit të organizuar. Praktika e përdorimit të mediave për shantazh rrezikon të bëhet diçka normale në Shqipëri dhe, duke pasur parasysh përhapjen e madhe të korrupsionit, pritshmëritë janë të pakta që raste të tilla të denoncohen dhe të hetohen. Shqipëria ka një mjedis mediatik të mbipopulluar për sa i përket numrit të mediave, por një treg të kufizuar reklamash dhe përqendrim të pronësisë së medias tek disa pronarë/familje që i përdorin ato si mjet për ndikim politik dhe përfitime ekonomike.

Në vitin 2021, cilësia e përmbajtjes së raportimeve si dhe pavarësia editoriale u përkeqësuan me rritjen e vetëcensurës nga gazetarët dhe zvogëlimit të hapësirës për gazetari të pavarur, kritike dhe investigative për shkak të frikësimit, presionit dhe ngacmimit. Numri i sulmeve ndaj sigurisë fizike dhe jetës së gazetarëve dhe të afërmeve të tyre është i vogël në Shqipëri. Megjithatë, edhe ato pak raste që raportohen nuk hetohen siç duhet ose nuk ka transparencë të mirëfilltë për këto hetime. Institucionet shtetërore në Shqipëri nuk kanë krijuar ende mekanizma efektivë të posaçëm për

gazetarët dhe stafin e mediave për t'uofruar atyre masa mbrojtëse kur ndjehen të kërcënuar.

Për sa i përket autoritetit rregullator të medias, vihet re se janë bërë hapa prapa në drejtim të pavarësisë së tij në vitin 2021 pas zgjedhjes në korrik të një personi të lidhur politikisht me partinë në pushtet si kryetar i Autoritetit të Mediave Audiovizive. Gjithashtu, RTSh ka funksionuar pa drejtor të përgjithshëm për 7 muaj, teksa drejtori i mëparshëm u arrestuar me akuzën për korrupsion. Në shtator 2021, qeveria njoftoi krijimin e një Agjencie të re për Media dhe Informim (AMI) që do të centralizonte në një agjenci të vetme marrëdhëniet me publikun dhe informacionin publik të ministrive dhe institucioneve të tyre, agjenci që filloi nga puna në fillim të vitit 2022. Në 2021, aksesit i kufizuar tek informacioni publik mbeti një pengesë e madhe për gazetarinë cilësore, veçanërisht për mediat kritike dhe investigative. Zbatimi me mangësi i kuarit ligjor për të drejtën e informimit, kryesisht për shkak të mungesës së vullnetit politik, kulturës së fshtësisë dhe ruajtjes së informacionit publik, dhe mekanizmave të mangët për zbatimin e masave të llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve qeveritare ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe pavarësinë e raportimit.

Ajo që kërcënon sigurinë e gazetarëve janë kushtet e tyre të punës, zbatimi i dobët i Kodit të Punës, sfidat specifike gjinore në sektorin e medias, shqetësimet e sigurisë dixhitale si dhe nxitja e ndjenjës së antipatisë ndaj mediave dhe presionet e përgjithshme kundër tyre. Një shqetësim tjetër madhor është përpjekja për ta bërë gazetarinë të duket si e dalë jashtë mode duke e ndërthurur me ndjenja antipatie kundër mediave, me gjuhë denigruese dhe mbyllje të dyerve ndaj gazetarëve duke mos dhënë konferenca për shtyp dhe duke përqendruar informacionin publik në pak duar. Ndjenjat e antipatisë kundër mediave shprehen nga aktorët politikë, veçanërisht nga kryeministri dhe deputetë dhe ministrat e Partisë Socialiste, të cilët vazhdimisht shtojnë presionet mbi mediat, sidomos ndaj mediave të pavarura, kritike dhe investigative.

Rekomandime

Rekomandime kryesore për politikëbërësit për secilën fushë janë si më poshtë:

Mbrojtja ligjore

- Të sigurohet zbatimi i plotë i garancive ligjore për lirinë e shprehjes dhe të medias si dhe të ofrohet një mjedis mediatik mundësues në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Të rishikohet legjislacioni për mediat për ta sjellë atë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare për lirinë e shprehjes, veçanërisht në lidhje me mediat online;
- Të sigurohet transparenca e reklamave publike dhe shtetërore;
- Të përmirësohet transparenca për pronësinë e mediave;
- Të krijohen dhe përmirësohen mekanizmat vetëregullues me kapacitete ekzekutive;
- Të ndryshohet Kodi Zgjedhor për të garantuar mundësi të barabarta për të gjitha partitë garuese për akses në media, përfshirë këtu edhe hapësirën e reklamave; të merret parasysh edhe mundësia e ndarjes së një sasive të barabartë kohe falas për kandidatët gjatë fushatës;
- Të ndryshohet ligji për të bërë të mundur që mediat të kenë mundësi në mënyrë të pavarur të mbulojnë aktivitetet e kandidatëve në fushatat zgjedhore me synim kufizimin e përdorimit të materialeve të gatshme të prodhuara nga partitë për edicionet e lajmeve.

Pozicioni i gazetarëve në redaksitë e lajmeve

- Të rritet transparencja dhe llogaridhënia e autoritetit rregullator të mediave;
- Të forcohet pavarësia e transmetuesit publik në shërbim të publikut;
- Të forcohet zbatimi i vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit/Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Të mbështetet dhe të përmirësohet barazia gjinore në redaksi;
- Të mbështetet dhe të përmirësohet raportimi për diversitetin.

Siguria e gazetarëve

- Të zbatohet një politikë e tolerancës zero për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, si dhe për kërcënimet ndaj medias, përfshirë këtu edhe në debatin politik;
- Të ofrohet mbrojtje dhe hapësirë e sigurt për gazetarët;
- Të zbatohet Kodi i Punës dhe të forcohet mbrojtja e të drejtave të punës, sigurimeve shoqërore dhe të drejtave sociale për gazetarët në Shqipëri edhe nëpërmjet krijimit të një sindikate gazetarësh forcimit të shoqatave të gazetarëve;
- Të mblidhen dhe botohen të dhëna të rregullta për sigurinë e gazetarëve, për kushtet e punës dhe çështje të tjera të lidhura me to;
 - Të ndiqet çështja e sigurisë digjitale të gazetarëve dhe të rriten kapacitetet e institucioneve publike për trajtimin e problemeve të sigurisë digjitale për gazetarët dhe profesionistët e mediave.

Rekomandimet kryesore për shoqatat e gazetarëve:

Për shoqatat e gazetarëve

- Të krijohet një platformë të përbashkët e shoqatave të gazetarëve, mediave dhe atyre që ofrojnë mbështetje ligjore dhe profesionale në bashkëpunim me nismat ekzistuese për gazetarët dhe redaktorët, siguria e të cilëve është nën kërcënim;
- Të mbështetet gazetaria fakt-verifikuese dhe ajo investigative, por të jepen edhe mesazhe të përgatitura mirë dhe qartë përmes të cilave qytetarët të kuptojnë proceset dhe marrëdhëniet dhe jo thjesht vetëm faktet e paraqitura;
- Të mbështeten gazetaret gra, gazetarët e rinj dhe gazetarët që punojnë në mediat lokale;
- Të ofrohet ngritja e kapaciteteve, të mobilizohen burimet dhe të mblidhen fonde për shoqatat e gazetarëve;
- Të krijohen dhe konsolidohen mekanizmat e vetë-rregullimit me kapacitete ekzekutive;
- Të rritet ndërgjegjësimi, mbështetja dhe fuqizimi i gazetarëve që ende nuk kanë vullnetin të raportojnë shkeljet e të drejtave të tyre të punës nga frika e humbjes së vendit të punës dhe për shkak të mungesës së besimit të sistemi i drejtësisë;
- Të rritet solidariteti mes shoqatave të gazetarëve për secilin rast të censurës ose sulmit ndaj anëtarëve dhe/ose përfaqësuesve të mediave për shkak të profesionit.

